



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) për raportimin e kryer për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve në Shqipëri**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË  
AGJENCINË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS  
KANALIZIMEVE (AKUK)  
PËR  
RAPORTIMIN E KRYER PËR PROGRAMIN KOMBËTAR TË  
MODERNIZIMIT TË SEKTORIT TË UJËSJELLËS  
KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI**

**TIRANË, shkurt 2026**

<b>NR.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>7</b>
1	Objektivat dhe qëllimi	
2	Identifikimi i çështjes	
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4	Përgjegjësitë e audituesve	
5	Kriteret e vlerësimit	
6	Standardet e auditimit	
7	Metodat e auditimit	
8	Dokumentimi i auditimit	
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>10</b>
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Auditi i raportit vjetor financiar të programit që përfshin shpenzimet korrente të AKUK dhe shpenzimeve kapitale specifike të përzgjedhura për arritjen e objektivave të programit për vitin 2024	
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>34</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:**

Për realizimin e projektit është lidhur marrëveshja e huasë në shumën 67.3 mln euro, e ratifikuar me Ligjin nr. 25, datë 23.03.2023 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare Për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”.

Objektivat e Programit janë përmirësimi i performancës operacionale dhe financiare të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve (UK) dhe rritja e aksesit në shërbimet e ujësjellësit të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Republikën e Shqipërisë.

Dhënia e opinionit financiar me një siguri të arsyeshme nga ana e audituesve nëse transaksionet financiare dhe shpenzimet ekonomike të Programit janë raportuar drejt dhe saktë në raportimin e kryer nga subjekti i audituar për Bankën Botërore për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 nëse janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Për auditimin Financiar, qëllimi i tij është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të raporteve financiare të raportuara nga AKUK për vitin 2024. Auditimi financiar do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) – ANEKSI A, dhe standardet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është një anëtar i INTOSAI-t. Këto standarde kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë të testit, të provave që mbështesin shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në raportet financiare. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të raporteve financiare.

Programi përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme:

### **Pjesa 1. Forcimi i Kuadrit Sektorial Kombëtar**

1. Miratimi i udhëzimeve të politikave me kriteret e përshtatshmërisë dhe metodologjinë për ndarjen e subvencioneve të financuara nga buxheti fiskal për NJQV-të dhe ndërmarrjet UK nga AKUM-i, në lidhje me sa vijon:

i. grante për NJQV dhe/ose ndërmarrjet UK për të mbuluar mungesat e të ardhurave si një përgjigje emergjente ndaj situatës së COVID-19 (“Grantet e COVID-19”) dhe grante të bazuara në performancë për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet UK për të mbuluar shpenzimet operacionale (“Grante të bazuara në performancë”);

ii. grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në eficiencë dhe përmirësimin e performancës, duke përfshirë infrastrukturën e ujësjellësit për vazhdimësinë e shërbimit, ngritjen e zonave të matura në rrethe, reduktimin e ujit pa të ardhura, matjen e vëllimeve të ujit dhe përmirësime të tjera në zonat urbane dhe zonat rurale, investimet për eficiencën e energjisë dhe masat e ndryshimit të ndërmarrjeve (“Grantet e Investimeve”);

iii. stimuj për proceset e grumbullimit ose ristrukturimit për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet UK (“Stimujt”); dhe

iv. grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në lidhjet e reja të ujësjellësit në zonat e pafurnizuara periurbane dhe rurale, duke përfshirë familjet në nevojë (“Grante Investimi për Lidhje të Reja”).

2. Mbështetja e koordinimit ndërmjet AKUM-it dhe ERRU-së për të kërkuar rregullimin e politikave në përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe për të promovuar miratimin e një udhëzuesi për planin e biznesit në përputhje me kërkesat rregullatore.

3. Mbështetja: i. e përhapjes së sistemit kombëtar të informacionit për të përmirësuar besueshmërinë e të dhënave të performancës/vlerësimit të ndërmarrjeve dhe duke mundësuar monitorimin e treguesve kryesorë të performancës së ndërmarrjes; ii. miratimin e programit

kombëtar të certifikimit për stafin e ndërmarrjeve UK; dhe iii. forcimin e kërkesave ekzistuese të qeverisjes korporative dhe mekanizmave të korrjgimit të ankesave, menaxhimin e aktiveve dhe sistemet e informacionit të menaxhimit në nivel lokal dhe qendror.

## **Pjesa 2. Përmirësimi i Performancës Operacionale dhe Financiare të Ndërmarrjeve UK**

1. Financimi: a) i Granteve të COVID-19; dhe b) Grantet e Bazuara në Performancë për NjQV-të e përzgjedhura dhe/ose Ndërmarrjet UK.
2. Financimi i Granteve të Investimeve për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK.
3. Stimuj financimi për NJQV-të e përzgjedhura dhe/ose ndërmarrjet UK.

## **Pjesa 3. Mbyllja e mangësive të Shërbimeve të Përgjithshme të Aksesit të Ujësjetllësit**

1. Financimi i Granteve të Investimeve të Lidhjes së Re për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK-së.

Nga auditimi rezultuan në mënyrë të përmbledhur:

- Pasqyrat financiare të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve përgatiten dhe mbahen në mënyrë manuale në programin Excel dhe nuk janë të integruara me sistemin e Thesarit apo me programe të dedikuara financiare. Kjo praktikë rrit ndjeshëm riskun për ndërhyrje apo ndryshime të paautorizuara në të dhënat financiare të raportuara, pa lënë gjurmë auditimi. Nga verifikimet e kryera rezultoi se vlerat e raportuara pranë Bankës Botërore bazohen në të dhënat e sistemit të Thesarit, mbi bazë cash, dhe nuk përputhen me pasqyrat financiare të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (akruuale).

- Nga llogaria 602 janë paguar rezervimet e hoteleve për udhëtime jashtë vendit sipas faturës së paraqitur nga agjenci turistike të kontaktuara nga punonjës të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe jo sipas faturave të hoteleve ku punonjësit kanë fjetur gjatë periudhës së shërbimit. Pagesat e kryera ndaj agjencive të udhëtimit/turistike janë në kundërshtim me pikën 9 të Vendimit të KM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” pasi rimbursimi i shpenzimeve të fjetjes në shërbimet jashtë vendit kryhet mbi bazën e faturave të marra në hotel. Si dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve nuk ka nxjerr rregulla të brendshme për organizimin e punës për sigurimin e hoteleve me koston më të ulët.

- Nga auditimi rezultoi se Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve nuk ka kryer asnjë kontroll nëpërmjet njësisë së posaçme të ngritur për këtë qëllim, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve, që ka përfituar nga fondi i subvencionit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 26.03.2024 “Për miratimin e Metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencionin shtetëror, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e Ujësjetllës - Kanalizimeve, për vitin buxhetor 2024”, pika 14 shkronja “k”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve” të ndryshuar neni 13.

Nga auditimi i veprimeve të kryera në llogarinë 602 rezultojnë se:

- Me Urdhër-shpenzimi nr. 296, datë 19.09.2024, me vlerën 1,019,646 lekë është paguar “Shërbimi i marrjes me qira të automjetit me shofer për strukturën e Task Forcës”. Nga auditimi i dosjes për këtë praktikë/procedurë prokurimi u konstatua se, Operatori Ekonomik fitues “M. S.” nuk plotësonte kriterin nr. 4 dhe 6 të Kriterëve të Përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Operatori Ekonomik është përzgjedhur fitues nga KVO edhe pse oferta e tij nuk rezultoi e vlefshme/suksesshme, veprime këto në mospërputhje me nenin 82 pika 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Në lidhje me Urdhër-shpenzimet për pagesën e qirasë së zyrave të Taskforcës, nga auditimi i dosjes për këtë praktikë/procedurë u konstatua: Vendosija e kërkesave (kriterëve) dhe përlllogaritja e sipërfaqes nuk është e argumentuar teknikisht/ligjërishit veprime në mospërputhje me nenin 36 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Dosjet fizike të prokurimit nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes, duke mos respektuar gjurmën e auditimit për procesin e prokurimit, në mospërputhje me nenet 21, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

- Gjatë procesit të auditimit të raportimit për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri, grupi i auditimit u përball me vështirësi në sigurimin dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, lidhur me projektet e zbatuara në bashkitë dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizime të miratuara nga Banka Botërore, konkretisht për urdhër-shpenzimet dhe dokumentacionin justifikues përkatës. Kjo si rrjedhojë e mungesës së një sistemi të konsoliduar për administrimin dhe koordinimin e dokumentacionit financiar ndërmjet Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe njësisive zbatuese në nivel vendor, si dhe me dobësitë në mekanizmat e kontrollit të brendshëm për mbledhjen, ruajtjen dhe vënien në dispozicion në kohë të dokumentacionit justifikues.

- Nga auditimi i llogarisë 231 (e cila përmban investime kapitale të projekteve të përzgjedhura nga Banka Botërore) rezulton se për projektet që zhvillohen nga bashkitë dhe ujësjellësit nuk rakordon vlera e urdhër-shpenzimeve të tyre me vlerën e raportuar nga BB. Konkretisht për 5 projekte vlera e raportuar te Banka Botërore është 341,004,000 lekë krahasuar me totalin e urdhër-shpenzimeve të bashkive dhe ujësjellësve në vlerën 187,204,480 lekë. Pra rezulton diferenca prej 153,799,520 lekësh për të cilën nuk u vendos në dispozicion dokumentacion justifikues, por vlera 341,004,000 lekë rakordon me shpenzimet e kryera nga sistemi i thesart të cilat janë baza mbi të cilat kryehet raportimi në kundërshtim me pikën 56 të PAD (Dokumenti i Vlerësimit të Programit).

Disa nga rekomandimet kryesore:

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa për integrimin e një sistemi (software) financiar për hartimin e pasqyrave financiare të projektit, ku të jenë të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që ka akses në sistem, duke ruajtur besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në to.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa për hartimin e një praktike rregullatore në lidhje me rezervimin e hoteleve në kuadër të udhëtimeve jashtë vendit, me qëllim analizimin e të gjitha opsioneve për sigurimin e tyre me çmim më të ulët.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mos kryerjen e kontrolleve dhe të marr masa në hartimin e një plani dhe kryerjen e kontrolleve mbi përdorimin e fondeve të akorduara për çdo shoqëri përfituese nga fondi i subvencionit.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e prokurimit, me qëllim garantimin e dokumentimit të plotë dhe të argumentuar teknikisht e ligjërishit të kriterëve të përcaktuara në procedurat e blerjeve me vlera të vogla, shqyrtimin me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm të ofertave të paraqitura, si dhe realizimin e inventarizimit të plotë të dosjeve të prokurimit.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa që, përpara hartimit dhe dorëzimit të raporteve financiare të programit pranë Bankës Botërore, të sigurojë disponimin e kopjeve shkresore ose elektronike të dokumentacionit justifikues për të gjitha llogaritë e

raportuara, përfshirë të dhënat e marra nga bashkitë dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizime të miratuara nga Banka Botërore.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të rakordojë urdhërshpenzimet e bashkive dhe ujësjellësave me vlerat e raportuara te Banka Botërore, dokumentacionin justifikues, si dhe të analizojë situatën e krijuar nga këto mungesa.

## **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

### **Opinioni i auditimit mbi raportet financiare:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar raportin financiar të përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve për llogari të Bankës Botërore, si detyrim që rrjedh nga marrëveshja e financimit, për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në raportin financiar, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të llogarive financiare.

### **Opinioni i pa modifikuar<sup>1</sup> me theksim çështje:**

“Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në llogaritë e 600-603 si dhe llogarinë e shpenzimeve kapitale të përzgjedhura për raportim sipas programit të subjektit Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve nuk janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator të raportimit financiar, dhe në gjykimin profesional të audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një opinionit të pa modifikuar me theksim çështje.”

### **Baza për opinionin e pa modifikuar me theksim çështje:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e këtij Raporti Auditimi. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n, ISSAI 200 Parimet e Auditimit Financiar dhe ISA 800 (ISSAI 2800, Konsiderata të veçanta, auditime të pasqyrave financiare të hartuara sipas një kuadri të veçantë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

### **Theksim i çështjes:**

Gjatë procesit të auditimit të raportimit për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri rezulton se lidhur me projektet e zbatuara në bashkitë dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizime të miratuara nga Banka Botërore, konkretisht për urdhërshpenzimet dhe dokumentacionin justifikues mungon një sistemi i konsoliduar për administrimin dhe koordinimin e dokumentacionit financiar ndërmjet Agjencisë Kombëtare të

<sup>1</sup> -Manuali Auditimit Financiar, llojet e opinioneve, fq. 55-66.

-(e shkëputur nga ISSAI 200) Forma e opinionit 147. Audituesi duhet të japë një opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare. Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të audituesit’. 148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit

Ujësjetllës Kanalizimeve dhe njërive zbatuese në nivel vendor, si dhe me dobësitë në mekanizmat e kontrollit të brendshëm për mbledhjen, ruajtjen dhe vënien në dispozicion në kohë të dokumentacionit justifikues.

Nga auditimi i llogarisë 231 rezulton se për projektet që zhvillohen nga bashkitë dhe ujësjetllësit nuk rakordon vlera e urdhër-shpenzimeve të tyre me vlerën e raportuar nga BB. Konkretisht për 5 projekte.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 711/1, datë 11/07/2025, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14/07/2025 deri në datën 30/09/2025, në Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve (AKUK) periudhën nga 01/01/2024 deri në datën 31/12/2024, u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve për raportimin e kryer për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetllës-Kanalizimeve në Shqipëri (Programi)”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. I. S., Përgjegjëse Grupi
2. I. B.
3. E. S.

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

### **1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:**

Dhënia e opinionit financiar me një siguri të arsyeshme nga ana e audituesve nëse transaksionet financiare dhe shpenzimet ekonomike të Programit janë raportuar drejt dhe saktë në raportimin e kryer nga subjekti i audituar për Bankën Botërore për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 nëse janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

### **2. Identifikimi i çështjes:**

Për auditimin Financiar, qëllimi i tij është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të raporteve financiare të raportuara nga AKUK për vitin 2024. Auditimi financiar do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) – ANEKSI A, dhe standardet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është një anëtar i INTOSAI-t. Këto standarde kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë të testit, të provave që mbështesin shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në raportet financiare. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të raporteve financiare.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Strukturat në Agjencia Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve (AKUK) janë përgjegjëse për raportimin drejtë dhe saktë të transaksioneve financiare për llogaritë 600, 601, 602, 603 dhe 231.

#### **4. Përgjegjësitë e audituesve:**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me implementimin e projektit shkallën e realizimit të objektivave etj. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

#### **5. Kriteret e vlerësimit:**

Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. Nr. 25/2023 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”. Kushtet për përgjithshme të marrëveshjes në fjalë.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

VKM nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”;

Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022;

Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së.

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

Udhëzim i MF nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”;

Udhëzimin e MF nr. 20, datë 24.12.2003 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësisve të menaxhimit, zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”;

Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e Njësisve të Menaxhimit të Projekteve etj.

#### **6. Standardet e auditimit:**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI/IFPP 100; 200; 400 etj.;

ISSAI 5220 Udhëzime Mbi Praktikën Më Të Mira Të Auditimit Të Financimit Privat /Publik Dhe Koncesioneve

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë-KLSH;

Manuali i Auditimit Financiar-KLSH;

Manuali i Zbatimit të Rekomandimeve.

#### **7. Metodat e auditimit:**

Auditim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

#### **8. Dokumentimi i auditimit:**

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara akt konstatimeve dhe akt verifikimeve, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të përgatitet Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

### III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

#### 1. Informacioni i përgjithshëm:

Për realizimin e projektit është lidhur marrëveshja e huasë në shumën 67.3 mln euro, e ratifikuar me Ligjin nr. 25, datë 23.03.2023 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare Për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”.

Objektivat e Programit janë përmirësimi i performancës operationale dhe financiare të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve (UK) dhe rritja e aksesit në shërbimet e ujësjellësit të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Republikën e Shqipërisë.

Marrëveshja e Huasë për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve të Shqipërisë - (“Programi”), u nënshkrua midis Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”) dhe Republikës së Shqipërisë më 15 dhjetor 2022. Objektivat e Programit janë përmirësimi i performancës operative dhe financiare të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve (UK) dhe rritja e aksesit në shërbimet e furnizimit me ujë të menaxhuar në mënyrë të sigurtë në Republikën e Shqipërisë. Programi u bë efektiv më 10 maj 2023 dhe data e mbylljes së tij është 31 dhjetor 2027. Shuma totale e huasë nuk do të kalojë 67.3 milion Euro dhënë si Program për Financimin e Rezultateve për të plotësuar financimin në financimin e Programit siç përshkruhet më poshtë.

Në bazë të Marrëveshjes së Huasë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përmes Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës dhe Kanalizime (AKUK) është përgjegjëse për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të Programit.

#### Përshkrimi i programit

Programi përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme:

#### Pjesa 1. Forcimi i Kornizës Sektoriale Kombëtare

1. Miratimi i udhëzimeve të politikave me kriteret dhe metodologjinë e pranueshmërisë për ndarjen e subvencioneve të financuara nga buxheti fiskal për NJQV-të dhe shoqëritë UK nga AKUM në lidhje me sa vijon:

- (i) grante për NJQV-të dhe/ose Shoqëritë UK për të mbuluar mungesat e të ardhurave si një përgjigje emergjente ndaj situatës së COVID19 (“Grantet e COVID19”) dhe grante të bazuara në performancë për NJQV-të dhe/ose shoqëritë UK për të mbuluar shpenzimet operationale (“Grante të bazuara në performancë”);
- (ii) grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në efikasitet dhe përmirësimin e performancës, duke përfshirë: infrastrukturën e furnizimit me ujë për vazhdimësinë e shërbimit, ngritjen e zonave të matjes së qarkut, reduktimin e ujit pa të ardhura, matjen e vëllimeve të ujit dhe përmirësime të tjera në zonat urbane dhe zonat rurale, investimet për efikasitetin e energjisë dhe masat e kthimit të ndërmarrjeve (“Grantet e Investimeve”).
- (iii) stimuj për proceset e grumbullimit ose ristrukturimit për NJQV-të dhe/ose shoqëritë UK (“Incentivat”); dhe
- (iv) grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në lidhjet e reja të furnizimit me ujë në zonat e pashërbyera peri-urbane dhe rurale, duke përfshirë për familjet në nevojë (“Grante Investimi për Lidhje të Re”).
- (v) Mbështetja e koordinimit ndërmjet AKUM dhe ERRU për të kërkuar përafrimin e politikave në përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe për të nxitur miratimin e një udhëzuesi të planit të biznesit në përputhje me kërkesat rregullatore.

Mbështetja (i) përhapja e sistemit kombëtar të informacionit për të përmirësuar besueshmërinë e performancës së ndërmarrjeve/ të dhënat e krahasimit dhe duke mundësuar monitorimin e treguesve kryesorë të performancës së ndërmarrjes; (ii) miratimin e programit kombëtar të

certifikimit për stafin e ndërmarrjeve UK; dhe (iii) forcimin e kërkesave ekzistuese të qeverisjes së korporatës dhe mekanizmave të korigjimit të ankesave, menaxhimit të aseteve dhe sistemet informacionit të menaxhimit në nivel lokal dhe qendror.

## **Pjesa 2. Përmirësimi i performancës operative dhe financiare të shoqërive UK**

1. Financimi (a) Grantet e COVID19 dhe (b) Grantet e Bazuara në Performancë për NJQV-të e përzgjedhura dhe/ose shoqëritë UK.
2. Financimi i Granteve të Investimeve për shoqëritë e përzgjedhura të UK.
3. Stimuj financimi për NJQV të përzgjedhura dhe/ose shoqëri UK.

## **Pjesa 3. Mbyllja e hendekut drejt aksesit universal në shërbimet e furnizimit me ujë**

1. Financimi i Granteve të Investimeve të Lidhjes së Re për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK.

## **Korniza e Shpenzimeve të Programit**

Programi i Shpenzimeve përbëhet nga aktivitetet, shpenzimet dhe rezultatet e pranueshme të identifikuar në tre fushat e rezultateve të Programit siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela nr 1: Burimi i financimit**

	në mln \$	
<b>Programi i shpenzimeve sipas zonave të rezultateve (pjesë)</b>	<b>USD</b>	<b>%</b>
Fusha e rezultateve Nr. 1: Forcimi i Kornizës Sektoriale Kombëtare	14.2	10.52
Fusha e rezultateve nr. 2: Përmirësimi i performancës operative dhe financiare të ndërmarrjeve UK	100.8	74,67
Zona e rezultateve nr. 3: Mbyllja e hendekut drejt aksesit universal në ujë Shërbimet e Furnizimit	20.0	14.81
<b>Gjithsej</b>	<b>135.0</b>	<b>100.00</b>
<b>Plani i financimit PforR (135 milion USD)</b>		
Qeveria Shqiptare	60.0	44.44
Ekivalenti i huasë nga IBRD në USD	75.0	55,56
<b>Gjithsej</b>	<b>135.0</b>	<b>100.00</b>

Burimi: AKUK

Zona nr. 1 e rezultateve përbën 100% të totalit të shpenzimeve operative të AKUK-ut, duke përfshirë pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe mallrat dhe shërbimet. Fusha e rezultateve nr.2 përfshin subvencionet të dhëna për NJQV-të e përzgjedhura dhe/ose shoqëritë UK si Grante për COVID19 dhe Grante të Bazuara në Performancë.

## **Treguesit e lidhur me disbursimin**

Në lidhje me Programin, Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huasë për të financuar Shpenzimet e Programit (përfshirë Tatimet), në bazë të rezultateve (“Rezultatet e Lidhura me Disbursimin” ose “DLR”) të arritura nga Huamarrësi, të matur kundrejt treguesve specifikë (“Treguesit e Lidhur me Disbursimin” ose “DLI”) të treguar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr 2: Shpërndarja sipas indikatorëve

në euro

Kategoria (duke përfshirë treguesin e lidhur me disbursimin sipas rastit)	Rezultati i lidhur me disbursimin	Shuma e huasë Alokuar (shprehur ne EUR)	Formula e disbursimit
(1) DLI #1: Përmirësimi i mekanizmave të financimit të sektorit dhe stimujve për performancën e miratuar	DLR #1.1 Huamarrësi ka miratuar udhëzimet e reja të mëposhtme me kriteret e pranueshmërisë dhe metodologjinë e bazuar në performancë për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i shtetit dhe monitorimin e përdorimit të tyre nga shoqëritë e ujësjellës kanalizime: (i) Udhëzues për subvencionet për ndikimet e COVID19 dhe shpenzimet operacionale. (ii) Udhëzues për subvencionet për investime kapitale për të përmirësuar efikasitetin operacional dhe gjendjen financiare. (iii) Udhëzues për subvencionet për stimujt për grumbullimin ose ristrukturimin e shoqërive UK. (iv) Udhëzues për subvencionet për investime kapitale për akses të ri në shërbimet e furnizimit me ujë në zonat e pashërbyera.	9,000,000	1,800,000 € për çdo udhëzues sipas DLR 1.1 (i), (ii), (iii) dhe (iv) dhe 1,800,000 € kur të gjitha udhëzimet e përmendura janë plotësuar, deri në 9,000,000 €
(2) DLI #2: Përmirësimi i shpërndarjes së shpenzimeve publike për sektorin UK	DLR # 2.1 AKUM ka akorduar në planin e tij buxhetor afatmesëm grante për NJQV-të dhe/ose shoqëritë UK në përputhje me udhëzimet e miratuara sipas DLR-ve 1.1(i), 1.1(ii), dhe 1.1(iii) dhe (iv).	22,131,750	1 € për çdo ekuivalent 1 € të ndarë deri në 22,131,750 €
(3) DLI #3: Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të sektorit UK	DLR # 3.1 10% Rezultati i Përmbledhur Kombëtar i Përmirësuar për Mbulimin Direkt të Kostos Operative, nga viti bazë 2022.	9,000,000	900,000 € për çdo rritje në 1% nga viti bazë 2022, deri në 9,000,000 €
(4) DLI #4: Vazhdimësia e përmirësuar e shërbimeve të furnizimit me ujë	DLR # 4.1 Të paktën tridhjetë e pesë zona urbane me minimum 18 orë furnizim me ujë nga një bazë prej pesëmbëdhjetë zonash urbane	9,000,000	450 000 € për çdo zonë të re urbane deri në 9,000,000 €
(5) DLI #5: Numri i lidhjeve të reja funksionale shtëpiake që ofrojnë shërbime të sigurta dhe të besueshme të ujit	DLR #5.1 Lidhje të reja funksionale të ujit në familjet jo të cënueshme, nga një bazë prej 0.  DRI # 5.2: Lidhje të reja funksionale të ujit për familjet në nevojë, nga një bazë prej 0.	18 000 000	(i) 1,400 € për çdo lidhje të re të ujit në familjet jo të cënueshme, deri në 12,600,000 €; dhe (ii) 1,800 € për çdo lidhje të re të ujit në familjet e cënueshme, deri në një shumë totale prej 18,000,000 € si për familjet jo të cënueshme (DLR#5.1) dhe për familjet e cënueshme (DLR#5.2).
(4) Tarifa e parë që duhet paguar në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje		168,250	

me seksionin 2.05 (b) të Kushteve të Përgjithshme			
(5) Kufiri i normës së interesit ose primi i kolarit të normës së interesit që duhet paguar në përputhje me seksionin 4.05 (c) të kushteve të përgjithshme			
<b>SHUMË TOTALE</b>		67,300,000	

Burimi: AKUK

Disbursimi i IBRD gjatë vitit 2024 përfshin tërheqjet e të ardhurave në bazë rezultateve të arritura nga Huamarrësi, që nga efektiviteti i programit.

**Tabela nr 4:** DLI e realizuara dhe disbursimet përkatëse

në \$

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 (ne EUR)	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 (ne EUR)	Kumulative
DLI 1	9,000,000		9,000,000
DLI 2	3,560,167	2,700,000	6,260,167
<b>Total</b>	<b>12,560,167</b>	<b>2,700,000</b>	<b>15,260,167</b>

Burimi: AKUK

Gjatë vitit 2024 është disbursuar 100% e vlerës së DLI #1: Përmirësimi i mekanizmave të financimit të sektorit dhe stimujve për performancën e miratuar, që konsiston në miratimin e udhëzimeve me kriteret e pranueshmërisë dhe metodologjinë e bazuar në performancë për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i shtetit dhe monitorimin e përdorimit të tyre nga shoqëritë rajonale të ujësjellës kanalizimeve. Gjithashtu është disbursuar dhe kundërvlera e DLI #2: Përmirësimi i shpërndarjes së shpenzimeve publike për sektorin UK për subvencionin e shpërndarë gjatë vitit 2024.

## 2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

### 2.1 Auditimi i raportit vjetor financiar të programit që përfshin shpenzimet korrente të AKUK dhe shpenzimeve kapitale specifike të përzgjedhura për arritjen e objektivave të programit për vitin 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacioni të konstatohet se:

**Tabela nr 5:** Raporti Financiar i vitit 2024

në mijë lekë

Nr. llog	Emërtimi	Realizimi	Plani i rishikuar	Plani fillestar	Ndryshimet në planin vjetor	Ndryshimi vjetor (Plan-Realizim)
600	Pagat	109,262	112,537	72,537	40,000	3,275
601	Kontributet e sigurimeve shoqërore	17,769	22,114	12,114	10,000	4,345
602	Mallrat dhe shërbimet	32,997	51,100	51,100	0	18,103
603	Subvencionet	350,000	350,000	350,000	0	0
	<b>Totali i shpenzimeve korrente</b>	<b>510,028</b>	<b>535,751</b>	<b>485,751</b>	<b>50,000</b>	<b>25,723</b>
231	Projektet investuese	3,666,869	3,731,342	3,118,732	612,610	64,473
231	Shpenzimet totale kapitale	<b>3,666,869</b>	<b>3,731,342</b>	<b>3,118,732</b>	<b>612,610</b>	<b>64,473</b>
	<b>Shpenzimet totale të programit</b>	<b>4,176,897</b>	<b>4,267,093</b>	<b>3,604,483</b>	<b>662,610</b>	<b>90,196</b>

Burimi: AKUK

**Bazuar në pikën 56 të PAD (Dokumenti i Vlerësimit të Programit) si dhe kërkesës së BB, KLSH do të auditojë raportet financiare të programit për gjithë jetëgjatësinë e tij, konkretisht:**

“56. Marrëveshjet e disbursimit

*Disbursimet do të bëhen mbi bazën e rezultateve të verifikuara, sipas DLI. Për çdo DLI, shumat e alokuara, afatet kohore, objektivat vjetore, kushtet për arritjen e rezultateve, paradhëniet, financimi i rezultateve paraprake, afatet për arritje dhe përcaktimi i shumës që do të disbursohet janë përcaktuar në Aneksin 2. Qeveria Shqiptare do të duhet të provojë që, nëpërmjet pasqyrave financiare të përgatitura rregullisht, shpenzimet neto të Programit janë të barabarta ose më shumë se shumat e financimit të Programit të Bankës. Deklaratat Financiare të Programit do të auditohen çdo vit nga Institucioni i Lartë Kombëtar i Auditimit (KLSH). Për rezultatet e mëparshme për këtë operacion parashikohet financimi në masën maksimale prej 3 milionë USD<sup>2</sup>. .....*”

Pasqyrat financiare të AKUK mbahen në programin Excel (manualisht) dhe jo të integruara me sistemin e Thesarit apo programeve për këtë qëllim. Ky fakt sjell si pasojë riskun e shtuar për ndërhyrje të mundshme mbi vlerat e raportuara në çdo moment dhe duke mos lënë asnjë gjurmë.

Rezulton se vlerat e raportuara te Banka Botërore janë vlerat e marra nga sistemi i thesarit dhe jo ato të pasqyrave financiare.

### **Paga (Llogaria 600)**

Nga AKUK u vendosën në dispozicion pasqyrat financiare dhe u krahasuan vlerat e raportuara te Banka Botërore.

**Tabela nr 6:** Llogaria 600

në mijë lekë				
		Vlera e raportuar në BB	Vlera në pasqyra financiare	Diferenca
600	Paga	109,262	115,434	6,172

Burimi: AKUK

Nga auditimi rezulton se ka një diferencë midis vlerës së raportuar në BB në vlerën 6,172 mijë lekë. Kjo diferencë vjen si pasojë e ndryshimit të bazës së raportimit. Pasqyrat e AKUK janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara ndërsa Raporti financiar i BB mbi vlerat monetare (bazë Cash).

Vlera e raportuar te BB përmban shpenzimet faktike për paga neto ku përfshin dhjetor 2023 + janar-nëntor 2024.

Gjithashtu konstatohet se ka një diferencë prej 25,644 lekë midis vlerës së paguar dhe totalit të listëpagesave kjo si pasojë e rregullimeve të kryera nga sektori i financës (vjetërsi apo ditë pune).

<sup>2</sup> Rezultatet e mëparshme do të lidhen me subvencionin e dhënë për vitet 2020 dhe 2021

**Tabela nr 7: Përmbledhje**

në lekë

<b>Sipas deklarimeve 2024:</b>		<b>Sipas Rakordimit me Thesarin:</b>	
Dhjetor 2023:	6,056,418.00	Dhjetor 2023:	5,820,326.00
Janar- Nëntor 2024:	103,467,646.00	Diferenca të papaguara TAP 2023:	-88,055.00
	<b>109,524,064.00</b>	Shtesa Shpërblime:	324,151.00
Raportimi të BB	<b>109,262,000.00</b>	Janar- Nëntor 2024:	103,442,067.00
Diferenca në raportim	262,064.00	Ndalesa 2024:	25,644.00
			<b>109,524,133.00</b>

Burimi: AKUK

Nga grupi i auditimit u morën me zgjedhje urdhërshpenzimet për pagat e muajve: janar, prill, gusht, tetor.

### **Janar 2024**

Me Urdhërshpenzimin nr. 15, datë 01.02.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji janar 2024 në vlerën 1,283,482 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 16, datë 01.02.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë dhe me kontratë të përkohshme, muaji janar 2024 në vlerën 688,909 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 17, datë 01.02.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë dhe me kontratë të përkohshme, muaji janar 2024 në vlerën 1,232,218 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 18, datë 01.02.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji janar 2024 në vlerën 662,144 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 19, datë 01.02.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji janar 2024 në vlerën 81,905 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 20, datë 01.02.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji janar 2024 në vlerën 319,732 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 21, datë 01.02.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji janar 2024 në vlerën 112,433 lekë;

**Total paga neto për muajin Shkurt 2024 në vlerën 4,380,817 lekë.**

### **Prill 2024**

Me Urdhërshpenzimin nr. 115, datë 02.05.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji prill 2024 në vlerën 1,283,102 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 116, datë 02.05.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë dhe me kontratë të përkohshme, muaji prill 2024 në vlerën 712,354 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 117, datë 02.05.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë dhe me kontratë të përkohshme, muaji prill 2024 në vlerën 1,366,866 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 118, datë 02.05.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji prill 2024 në vlerën 564,582 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 119, datë 02.05.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji prill 2024 në vlerën 89,706 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 120, datë 02.05.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji prill 2024 në vlerën 260,437 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 121, datë 02.05.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji prill 2024 në vlerën 108,836 lekë;

**Total paga neto për muajin prill 2024 në vlerën 4,446,249 lekë.**

## **Gusht 2024**

Me Urdhërshpenzimin nr. 270, datë 02.09.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji gusht 2024 në vlerën 2,8744,967 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 271, datë 02.09.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë dhe me kontratë të përkohshme, muaji gusht 2024 në vlerën 692,055 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 272, datë 02.09.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë dhe me kontratë të përkohshme, muaji gusht 2024 në vlerën 4,323,248 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 273, datë 02.09.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji gusht 2024 në vlerën 743,458 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 274, datë 02.09.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji gusht 2024 në vlerën 308,290 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 275, datë 02.09.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji gusht 2024 në vlerën 255,269 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 276, datë 02.09.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji gusht 2024 në vlerën 211,958 lekë;

**Total paga neto për muajin gusht 2024 në vlerën 9,465,937 lekë.**

## **Tetor 2024**

Me Urdhërshpenzimin nr. 352, datë 01.11.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji tetor 2024 në vlerën 2,892,667 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 353, datë 01.11.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë dhe me kontratë të përkohshme, muaji tetor 2024 në vlerën 694,502 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 354, datë 01.11.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë dhe me kontratë të përkohshme, muaji tetor 2024 në vlerën 4,614,749 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 355, datë 01.11.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji tetor 2024 në vlerën 639,490 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 356, datë 01.11.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji tetor 2024 në vlerën 433,829 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 357, datë 01.11.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji tetor 2024 në vlerën 362,310 lekë;

Me Urdhërshpenzimin nr. 358, datë 01.11.2024, është kryer pagesa për pagat e punonjësve e miratuar në organikë, muaji tetor 2024 në vlerën 198,619 lekë;

**Total paga neto për muajin tetor 2024 në vlerën 9,836,158 lekë.**

Grupi i auditimit mori fletët kontabël duke parë kontabilizimet përkatëse dhe rezultoi se kontabilizimi i tyre është i drejtë.

## **Sigurime Shoqërore (Llogaria 601)**

Nga AKUK u vendosën në dispozicion pasqyrat financiare dhe u krahasuan vlerat e raportuara te Banka Botërore.

**Tabela nr 8:** Llogaria 601

në mijë lekë				
		Vlera e raportuar në BB	Vlera në pasqyra financiare	Diferenca
601	Sigurime shoqërore	17,769	12,641	5,128

Burimi: AKUK

Nga auditimi rezulton se ka një diferencë midis vlerës së raportuar në BB në vlerën 5,128 mijë lekë. Kjo diferencë vjen si pasojë e ndryshimit të bazës së raportimit. Pasqyrat e AKUK janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara ndërsa Raporti financiar i BB mbi vlerat monetare (bazë Cash).

**Tabela nr 9: Përmbledhje**

në lekë

	Sigurime Shoqërore	Sigurime Shëndetësore	Total
Dhjetor 2023	812,728.00	103,014.00	915,742
Janar 2024	796,595.00	93,433.00	890,028
Shkurt 2024	790,203	92,709.00	882,912
Mars 2024	792,009	92,932.50	884,942
Prill 2024	809,610	94,863.50	904,474
Maj 2024	1,415,795	165,181.50	1,580,977
Qershor 2024	1,588,940	184,829.00	1,773,769
Korrik 2024	1,735,123	203,586.50	1,938,710
Gusht 2024	1,758,626	204,005.00	1,962,631
Shtator 2024	1,797,230	208,646.00	2,005,876
Tetor 2024	1,827,379	212,031.00	2,039,410
Nëntor 2024	1,782,891	207,071.00	1,989,962
<b>Totali</b>			<b>17,769,431</b>

Burimi: AKUK

U morën Urdhërshpenzimet si dhe formularët e deklarimit dhe nga totali i tyre nuk ka diferenca me vlerën e raportuar në BB.

Nga grupi i auditimit u morën me zgjedhje urdhërshpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatime të muajve: janar, prill, gusht, tetor.

#### **Janar 2024**

Me Urdhërshpenzimin nr. 24, datë 09.02.2024, është kryer pagesa për tatime, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, muaji janar 2024 në vlerën 2,004,726 lekë;

#### **Prill 2024**

Me Urdhërshpenzimin nr. 136, datë 16.05.2024, është kryer pagesa për pagesa për tatime, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, muaji prill 2024 në vlerën 2,028,468 lekë;

#### **Gusht 2024**

Me Urdhërshpenzimin nr. 288, datë 11.09.2024, është kryer pagesa për tatime, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, muaji gusht 2024 në vlerën 4,494,138 lekë;

#### **Tetor 2024**

Me Urdhërshpenzimin nr. 373, datë 12.11.2024, është kryer pagesa për tatime, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, muaji tetor 2024 në vlerën 4,672,884 lekë;

#### **Shpenzime operative (602)**

Nga AKUK u vendosën në dispozicion pasqyrat financiare dhe u krahasuan vlerat e raportuara te Banka Botërore.

**Tabela nr 10: Llogaria 602**

në mijë lekë

		Vlera e raportuar në BB	Vlera në pasqyra financiare	Diferenca
602	Shpenzime Operative	32,997	32,997	0

Burimi: AKUK

Nga auditimi rezulton që nuk ka diferenca midis vlerës së raportuar në BB dhe pasqyrave financiare të AKUK.

Nga AKUK u vendos në dispozicion kontabilizimet analitike të kësaj llogarie, nga grupi i auditimit u krye verifikimi i kontabilizimeve dhe u konstatua se ato janë kryer në llogaritë e duhura.

U morën me zgjedhje veprime të kësaj llogarie me vlerë mbi 100,000 lekë, duke audituar urdhër shpenzimet dhe dokumentacioni justifikues, konkretisht:

Urdhërshpenzimi nr. 30, datë 15.02.2024 me vlerë 288,035 lekë për shërbimin e rojeve, bashkëlidhur praktikës Kontrata e shërbimit nr. 1186/3, datë 18.07.2023 (17 ditë), fatura tatimore nr. 19/2024 datë 18.01.2024 si dhe Procesverbali nr.299, datë 05.02.2025 për kryerjen e shërbimit.

Urdhërshpenzimi nr. 43, datë 07.03.2024 me vlerë 339,600 lekë për shpenzime për blerje jelek, bexho, stikera dhe dosje task-forca, bashkëlidhur Urdhër prokurimi nr. 154/1, datë 19.01.2024, Kontrata nr. 154/5, datë 12.02.2024, Fatura nr. 491/2024, datë 26.02.2024, Fletë - Hyrje nr. 1, datë 26.02.2024, Procesverbal i marrjes në dorëzim datë 26.02.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 49, datë 08.03.2024 me vlerë 126,385 lekë për pagesë hoteli udhëtim jashtë vendit, bashkëlidhur relacion i aktivitetit, faturë e operatorit ekonomik nr. 1/2024 S. T. 2014.

Urdhërshpenzimi nr. 50, datë 11.03.2024 me vlerë 320,000 lekë për Mirëmbajtje azhurnim, përmirësim dhe zhvillime të tjera të faqes zyrtare të SHRUK, bashkëlidhur Urdhër prokurimi nr. 1968, datë 31.10.2023, Kontratë shërbimi nr. 1968/4, datë 16.11.2023, Shkresë për pagesë nr. 815, datë 07.03.2024, Faturat nr. 19/2023 datë 14.12.2023, Fatura nr. 20/2023 datë 14.12.2023, Fatura nr. 3/2024 datë 08.02.2024, Fatura nr. 4/2024 datë 06.03.2024 bashkëlidhur procesverbalet e kryerjes së shërbimit nëntor 2023 - shkurt 2024.

Urdhërshpenzimi nr. 64, datë 03.04.2024 me vlerë 148,500 lekë për udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur Urdhër për pagesë diete nr. 1067, datë 03.04.2024, Listë pagesë datë 03.04.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 66, datë 03.04.2024 me vlerë 363,000 lekë për udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur Urdhër për pagesë diete nr. 1067, datë 03.04.2024, Listë pagesë datë 03.04.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 67, datë 03.04.2024 me vlerë 293,660 lekë për udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur Urdhër për pagesë diete nr. 1067, datë 03.04.2024, Listë pagesë datë 03.04.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 97, datë 15.04.2024 me vlerë 120,000 lekë për marrje ambienti me qira për organizim event, urdhër nr. 921/1, datë 18.03.2024, faturë 707/2024, datë 19.03.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 139, datë 17.05.2024, me vlerë 2,499,906 lekë, blerje karburanti naftë, Kontratë marrëveshje kuadër nr. 2265/1, datë 12.12.2022, Faturë nr. 25403/2024, Fletë Hyrje nr. 11, datë 15.05.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 147, datë 23.05.2024, me vlerë 290,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 148, datë 23.05.2024, me vlerë 128,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 154, datë 28.05.2024, me vlerë 154,530 lekë, Urdhër prokurimi nr. 1333/3, datë 07.05.2024. Faturë nr. 377/2024, datë 09.05.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 155, datë 28.05.2024, me vlerë 480,000 lekë, Blerje kamera për inspektorët e task forcës, Urdhër prokurimi nr. 1188/1, datë 02.05.2024, Kontratë nr. 1188/7 datë 17.05.2024, faturë nr. 61076/2024, datë 20.05.2024, Fletë - Hyrje nr. 12, datë 20.05.2024, Procesverbal marrje në dorëzim datë 20.05.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 156, datë 28.05.2024, me vlerë 442,112 lekë, Pagesë hoteli udhëtim jashtë vendit, Autorizim nr. 1333/1 datë 03.05.2024, Memo për pagesë nr. 1333/7, datë 20.05.2024, faturë nr. 464/2024, datë 27.05.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 157, datë 29.05.2024, me vlerë 316,500 lekë, Marrje me qira ambiente zyrash për strukturën e task forcës dhe shpenzime administrative maj 2024, Njoftim fituesi nr. 1132/1, datë 15.04.2024, Kontratë nr. 1306, datë 30.04.2024, Fatura nr. 474/2024, datë 23.05.2024, Faturë nr. 475/2024, datë 23.05.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 189, datë 25.06.2024, me vlerë 316,500 lekë, Marrje me qira ambiente zyrash për strukturën e task forcës dhe shpenzime administrative qershor 2024, Kontratë nr. 1306, datë 30.04.2024, Fatura nr. 563/2024, datë 07.06.2024, Faturë nr. 564/2024, datë 07.06.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 190, datë 25.06.2024, me vlerë 279,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 191, datë 25.06.2024, me vlerë 302,500 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 193, datë 26.06.2024, me vlerë 494,400 lekë, Shpenzim për blerje blloqe procesverbal, Urdhër prokurimi nr. 1383/1, datë 10.05.2024, Kontratë nr. 1520 datë 23.05.2024, faturë nr. 535/2024, datë 03.06.2024, Fletë - Hyrje nr. 14, datë 03.06.2024, Procesverbal marrje në dorëzim nr. 1520/1 datë 03.06.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 221, datë 15.07.2024, me vlerë 569,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 222, datë 15.07.2024, me vlerë 1,133,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 225, datë 30.07.2024, me vlerë 316,500 lekë, Marrje me qira ambiente zyrash për strukturën e task forcës dhe shpenzime administrative korrik 2024, Kontratë nr. 1306, datë 30.04.2024, Fatura nr. 624/2024, datë 01.07.2024, Faturë nr. 625/2024, datë 01.07.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 250, datë 12.08.2024, me vlerë 408,500 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 251, datë 12.08.2024, me vlerë 630,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 258, datë 22.08.2024, me vlerë 316,500 lekë, Marrje me qira ambiente zyrash për strukturën e task forcës dhe shpenzime administrative gusht 2024, Kontratë nr. 1306, datë 30.04.2024, Fatura nr. 712/2024, datë 02.08.2024, Faturë nr. 713/2024, datë 02.08.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 262, datë 22.08.2024, me vlerë 136,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 268, datë 29.08.2024, me vlerë 384,433 lekë, pagesë për taksën e ndikimit në infrastrukturë të objektit "Rikonstruksion i skemës së furnizimit me ujë për fshatin Podgoricë, Bashkia Maliq", bashkëlidhur Shkresë për pagesë nr. 2530, datë 29.08.2024, Faturë për arkëtim nr. 679, datë 28.08.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 283, datë 10.09.2024, me vlerë 762,788 lekë, Shërbimi roje korrik, gusht, bashkëlidhur kontrata nr. 2115/1, datë 18.07.2024, Faturë nr. 2044/2024, datë 31.07.2024, Faturë nr. 2555/2024, datë 31.08.2024 dhe procesverbalet përkatëse.

Urdhërshpenzimi nr. 296, datë 19.09.2024, me vlerën 1,019,646 lekë, Shërbim i marrjes me qira të automjetit me shofer për strukturën e Task Forcës, bashkëlidhur Urdhër prokurimi nr. 1392/1, datë 16.05.2024, Kontratë nr. 1560, datë 28.05.2024, faturë nr. 102/2024, datë 02.09.2024, Procesverbal datë 27.08.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 297, datë 19.09.2024, me vlerë 316,500 lekë, Marrje me qira ambiente zyrash për strukturën e task forcës dhe shpenzime administrative shtator 2024, Kontratë nr. 1306, datë 30.04.2024, Fatura nr. 798/2024, datë 04.09.2024, Faturë nr. 799/2024, datë 04.09.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 298, datë 24.09.2024, me vlerë 498,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 299, datë 24.09.2024, me vlerë 828,500 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 320, datë 04.10.2024, me vlerë 240,000 lekë, Përkthim i dokumenteve zyrtare, Kontratë nr. 2218/6, datë 05.08.2024, Faturë 48/2024, datë 22.08.2024, Procesverbal dorëzim dokumentacioni datë 09.08.2024, Faturë nr. 54/2024, datë 10.09.2024, Procesverbal dorëzim dokumentacioni datë 03.09.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 321, datë 04.10.2024, me vlerë 236,400 lekë, Shpenzime për goma automjetesh dhe bateri, Urdhër prokurimi nr. 2497, datë 27.08.2024, Kontratë nr. 2497/6, datë 04.09.2024, Faturë nr. 2786/2024, datë 10.09.2024, Faturë nr. 2969/2024, datë 25.09.2024, Fatura nr. 2990 datë 26.09.2024 si dhe Akt dorëzimet përkatëse.

Urdhërshpenzimi nr. 324, datë 09.10.2024, me vlerë 420,000 lekë, Materiale Pastrimi, Urdhër prokurimi nr. 2062/1, datë 20.08.2024, Kontratë nr. 2062/5, datë 03.09.2024, Faturë nr. 78/2024, datë 09.09.2024, Fletë Hyrje nr. 15, datë 09.09.2024. Procesverbali i marrjes në dorëzim nr. 2062/6, datë 09.09.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 325, datë 09.10.2024, me vlerë 5,564,592 lekë, Shërbim roje dhjetor 2023 – Janar 2024, Kontratë nr. 81/1, datë 27.01.2023, Faturë nr. 3722/2024, datë 03.01.2024, Procesverbal dhjetor (01.12.2023 – 30.12.2023), Fatura nr. 28/2024 datë 29.01.2024, Procesverbal janar (01.01.2024 – 26.01.2024).

Urdhërshpenzimi nr. 326, datë 09.10.2024, me vlerë 525,243 lekë, Shërbim roje shtator, Kontratë nr. 2115/1, datë 18.07.2024, Faturë nr. 2906/2024, datë 30.09.2024, Procesverbal (01.09.2024 – 30.09.2024) nr. 2888, datë 01.10.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 332, datë 10.10.2024, me vlerë 142,692 lekë, Shërbim për mirëmbajtje automjeti, Urdhër Prokurimi nr. 332, datë 10.10.2024, Fatura nr. 2791, datë 25.09.2024, Fatura nr. 2795, datë 25.09.2024, Fatura nr. 2796, datë 25.09.2024, Fatura nr. 2798, datë 24.09.2024, Procesverbalet e kryerjes së shërbimit bashkëlidhur.

Urdhërshpenzimi nr. 346, datë 24.10.2024, me vlerë 316,500 lekë, Marrje me qira ambiente zyrash për strukturën e task forcës dhe shpenzime administrative tetor 2024, Kontratë nr. 1306, datë 30.04.2024, Fatura nr. 55/2024, datë 07.10.2024, Faturë nr. 56/2024, datë 07.10.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 363, datë 01.11.2024, me vlerë 148,500 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 370, datë 08.11.2024, me vlerë 525,243 lekë, Shërbim roje tetor, Kontratë nr. 2115/1, datë 18.07.2024, Faturë nr. 3289/2024, datë 31.10.2024, Procesverbal (01.10.2024 – 31.10.2024) nr. 3214, datë 29.10.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 378, datë 20.11.2024, me vlerë 316,500 lekë, Marrje me qira ambiente zyrash për strukturën e task forcës dhe shpenzime administrative nëntor 2024, Kontratë nr. 1306, datë 30.04.2024, Fatura nr. 149/2024, datë 07.11.2024, Faturë nr. 150/2024, datë 07.11.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 384, datë 25.11.2024, me vlerë 1,823,344 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 385, datë 25.11.2024, me vlerë 123,500 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 386, datë 25.11.2024, me vlerë 137,000 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 414, datë 11.12.2024, me vlerë 316,500 lekë, Marrje me qira ambiente zyresh për strukturën e task forcës dhe shpenzime administrative dhjetor 2024, Kontratë nr. 1306, datë 30.04.2024, Fatura nr. 246/2024, datë 03.12.2024, Faturë nr. 247/2024, datë 03.12.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 415, datë 11.12.2024, me vlerë 525,243 lekë, Shërbim roje nëntor, Kontratë nr. 2115/1, datë 18.07.2024, Faturë nr. 3660/2024, datë 30.11.2024, Procesverbal nëntor (01.10.2024 – 31.10.2024) nr. 3530, datë 02.12.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 416, datë 11.12.2024, me vlerë 117,847 lekë, Rinovim kontrate për programin financiar Alpha Biznes. Urdhër prokurimi nr. 3290/1, datë 11.11.2024, Kontratë 3290/2 datë 11.11.2024, Faturë nr. 1847/2024 datë 11.11.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 427, datë 24.12.2024, me vlerë 461,640 lekë, Kancelari, Urdhër prokurimi nr. 2710/1 datë 18.09.2024, Kontratë 2710/4, datë 01.10.2024, Faturë nr. 18882/2024, datë 06.12.

2024, Fletë hyrje nr. 17, datë 06.12.2024, Procesverbal i marrjes në dorëzim datë 06.12.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 500, datë 15.01.2025, me vlerë 128,500 lekë, Udhëtime dieta brenda vendit, bashkëlidhur urdhrat e shërbimit si dhe dokumentacioni justifikues, si dhe lista përmbledhëse.

Urdhërshpenzimi nr. 504, datë 16.01.2025, me vlerë 525,243 lekë, Shërbim roje dhjetor, Kontratë nr. 2115/1, datë 18.07.2024, Faturë nr. 4131/2024, datë 31.12.2024, Procesverbal dhjetor (01.10.2024 – 31.10.2024) nr. 3889, datë 02.12.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 508, datë 16.01.2025, me vlerë 120,000 lekë, shpenzime për goma automjetesh, Urdhër Prokurimi nr. 2497, datë 27.08.2024, Kontratë nr. 2497/6, datë 04.09.2024, Faturë nr. 30853/2024, datë 26.12.2024, Aktdorëzimi datë 26.12.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 509, datë 16.01.2025, me vlerë 300,948 lekë, Shërbim për mirëmbajtje automjeti, Urdhër Prokurimi nr. 1512/3, datë 29.07.2024, Fatura nr. 4025, datë 27.12.2024, Kontrata nr. 2300/1, datë 13.08.2024, Fatura nr. 4026, datë 27.12.2024, Fatura nr. 4071, datë 31.12.2024, Procesverbalet e kryerjes së shërbimit bashkëlidhur.

Urdhërshpenzimi nr. 516, datë 21.01.2025, me vlerë 214,400 lekë, Përkthim i dokumenteve zyrtare “Furnizim vendosje për pajisjet e laboratorëve të Shoqërive Rajonale UK”, Kontratë nr. 2899/4, datë 04.10.2024, Fatura 75/2024, datë 13.12.2024, Procesverbal për marrje në dorëzim dokumentacionin datë 05.11.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 521, datë 23.01.2025, me vlerë 2,716,800 lekë, Përkthim i dokumenteve zyrtare “Sistemi i ri KUZ + ITUP në zonën turistike të Spillesë ...”, Kontratë nr. 3348/5, datë 13.11.2024, Fatura 73/2024, datë 13.12.2024, Procesverbal për marrje në dorëzim dokumentacionin datë 19.11.2024, Kontratë nr. 3463/5, datë 25.11.2024, Fatura 74/2024, datë 13.12.2024, Procesverbal për marrje në dorëzim dokumentacionin datë 02.12.2024, Kontratë nr. 2898/5, datë 02.10.2024, Fatura 80/2024, datë 27.12.2024, Procesverbal për marrje në dorëzim dokumentacionin datë 03.10.2024.

Nga auditimi urdhërshpenzimeve të mësipërme u konstatua se në dy raste janë kryer pagesa ndaj 2 agjencive turistike/udhëtimeve për rezervimin e dhomave të hotelit, konkretisht:

**Tabela nr 11: Pagesa hoteli**

në lekë

Nr.	Nr. USH	Data USH	Përfituesi	Përshkrimi	Vlera
1	49	08/03/2024	S. T.	Shpenzime hoteli jashtë vendi	126,385
2	156	28/05/2024	H. T.	Pagesa hoteli	442,112
<b>Totali</b>					<b>568,497</b>

Burimi: AKUK

Pagesat e kryera ndaj agjencive të udhëtimit/turistike janë në kundërshtim me pikën 9 të Vendim të KM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”:

“9. Në shpenzimet e fjetjes përfshihet fatura e hotelit të përzgjedhur, si rregull, në mënyrë të diferencuar, për kategoritë sipas numrave rendorë të lidhjes nr.1, si më poshtë vijon:

a) për kategoritë 1, 2, 3-hotel deri me 5 yje;

b) për kategoritë 4, 5, 6-hotel deri me 4 yje;

c) për kategoritë 7, 8-hotel deri me 3 yje.

Në raste të veçanta, kur organizohen veprimtari ndërkombëtare, ku rezervimi bëhet nga organizatorët ose organizimi i veprimtarisë nuk lejon ndarjen e grupit në hotele të ndryshme, shpenzimet e fjetjes njihen sipas faturës përkatëse. Në rastet kur distanca nga hoteli në destinacionin ku kryhet veprimtaria, duke respektuar kategoritë e mësipërme, është e konsiderueshme, drejtuesi i institucionit miraton, në urdhrin e shërbimit, lëvizjen në kategoritë e mësipërme të hotelit (jo më shumë se një kategori). Çdo institucion nxjerr rregulla të brendshme për organizimin e punës për sigurimin e hoteleve me koston më të ulët.”

Gjithashtu u shqyrtuan edhe pagesat për konsulentët e drejtorit, konkretisht:

Urdhërsërbimi nr. 22, datë 01.02.2024 Pagesë e shërbimit të këshilltarit me vlerën 30,909 lekë, Urdhëri nr. 126, datë 17.01.2024 “Për emërimin e z. M. M. në detyrën e këshilltarit të jashtëm”, Kontratë Shërbimi nr. 126/1, datë 18.01.2024 me afat 18.01.2024-31.12.2024.

Urdhërsërbimi nr. 23, datë 01.02.2024 Pagesë e shërbimit të këshilltarit me vlerën 64,909 lekë, Urdhëri nr. 31, datë 05.01.2024 “Për emërimin e znj. E. S. në detyrën e këshilltarit të jashtëm”, Kontratë Shërbimi nr. 31/1, datë 05.01.2024 me afat 03.01.2024-31.12.2024.

**Tabela nr 12: Përmbledhëse**

në lekë

Nr.	Nr. USH	Data USH	Përshkrimi	Vlera
1	22	01/02/2024	Pagesë shërbim këshilltari Union	30,909
2	23	01/02/2024	Pagesë shërbim këshilltari Credins	64,909
3	38	01/03/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit shkurt Union	68,000
4	39	01/03/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit shkurt BKT	68,000
5	62	02/04/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit mars Union	68,000
6	63	02/04/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit mars BKT	68,000
7	123	02/05/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit prill Credins	68,000
8	130	16/05/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit prill Credins	68,000
9	166	09/06/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit maj Union	27,818
10	167	03/06/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit maj Credins	68,000
11	205	02/07/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit qershor Raiffeisen	85,000
12	206	02/07/2024	Pagesë e shërbimit të këshilltarit qershor Credins	68,000
13	240	01/08/2024	Pagesë e Këshilltareve Raiffeisen	93,500
14	241	01/08/2024	Pagesë e Këshilltarit Credins	68,000
15	277	02/09/2024	Pagesë e Këshilltarëve Raiffeisen	93,500
16	278	02/09/2024	Pagesë e Këshilltarit Credins	68,000
17	311	01/10/2024	Pagesë e Këshilltarëve Raiffeisen	93,500
18	312	01/10/2024	Pagesë e Këshilltarit Credins	68,000
19	359	01/11/2024	Pagesë e Këshilltarëve Raiffeisen	93,500
20	360	01/11/2024	Pagesë e Këshilltarit Credins	68,000
21	397	02/12/2024	Pagesë e Këshilltarëve Raiffeisen	93,500

22	398	02/12/2024	Pagesë e Këshilltarit Credins	68,000
23	475	10/01/2025	Pagesë e Këshilltarëve Raiffeisen	93,500
24	476	10/01/2025	Pagesë e Këshilltarit Credins	68,000
<b>Totali</b>				<b>1,721,636</b>

Burimi: AKUK

Nga llogaria 602 është kryer pagesa e këshilltarëve të jashtëm të Drejtorit të Përgjithshëm bazuar në kontratë shërbimi. Nga vlera e paguar është mbajtur tatimi në burim në masën 15%. Kjo marrëdhënie pune e trajtuar si kontratë shërbimi është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nuk janë mbajtur sigurimet shoqërore dhe shëndetësore përkatëse.

Gjithashtu kontratat e shërbimit të lidhura kanë si bazë ligjore Kodin Civil dhe urdhrin e emërimit në detyrë ndërsa vetë urdhri bazohet në Kodin e Punës dhe VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarët e kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësit civilë dhe nëpunësit në disa institucione të administratës publike”, çka sjell një përplasje midis këtyre dy akteve.

Nga AKUK nuk u vendos asnjë praktikë dokumentare mbi nevojën për shërbimin e këshillimit, mbi mënyrën e përzgjedhjes së këshilltarëve si dhe punën e kryer nga ta. Në kontratat e hartuara dhe firmosura nuk ka të parashikuar asnjë detyrim mbi dorëzimin e produktit të punës e as kohë qëndrimi në institucion.

Në lidhje me Urdhërshpenzimi nr. 296, datë 19.09.2024, me vlerën 1,019,646 lekë, Shërbim i marrjes me qira të automjetit me shofer për strukturën e Task Forcës, u konstatua:

Me shkresën nr. 1392 Prot., datë 09.05.2024 përgjegjësi i sektorit të Burimeve Njerëzore i është drejtuar Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël me një kërkesë për “Shërbim marrje makina me qira me shofer për strukturën e Task-Forcë”.

Me shkresën nr. 1471 Prot., datë 15.05.2024 titullari i Institucionit ka nxjerrë Urdhërin e Brendshëm nr. 87 për “Përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike”.

Grupi i punës përbëhet nga A. G., J. H. dhe J. C..

Me shkresën nr. 1471/1 prot., datë 16.05.2024, komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit ka mbajtur proces-verbalin për përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike. Ky procesverbal është firmosur vetëm nga një prej anëtarëve të komisionit veprim ky në mospërputhje me nenin 2 pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Gjithashtu në proces-verbal nuk është pasqyruar mënyra e përcaktimit të fondit limit. Tre ofertat që janë paraqitur për studimin e tregut nuk kanë datë dhe nuk janë protokolluar pranë institucionit. Përlllogaritja e fondit limit nuk është bërë në përputhje me nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me shkresën nr. 1392/1 Prot., datë 16.05.2024 është nxjerrë urdhër prokurimi për prokurim me vlerë të vogël. Ky komision përbëhet nga M. M., B. H. dhe K. S..

Me shkresën nr.1392/2 prot., datë 16.05.2024, Komisioni i blerjeve të vogla ka mbajtur proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën “Shërbim marrje makina me qira me shofer për strukturën Task-Forcë”. Komisioni ka vendosur në Kriteret e Përgjithshme të pranimit/kualifikimit në pikën 4, 6 dhe 8 ofertuesi duhet të dorëzojë:

*Pika 4 Dokument vërtetues për përvojën e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiare të aktivitetit të O.E.*

*Pika 6 Mjeti të jetë i pajisur me siguracion të detyrueshëm TPL si dhe siguracion i plot KASKO(mbulim për vjedhje /zjarr/dëme) për të gjithë periudhën e qirasë së plotë operationale dhe*

Pika 8 *Operatori ekonomik duhet të sigurojë dhe shofer për automjetet (të pajisur me leje drejtimi përkatëse, kontratë pune).*

Me shkresën nr. 1392/3 prot., datë 16.05.2024 Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë Ftesë për ofertë. O.E. M. S. me Nipt L. me ofertë 849,555 lekë pa tvsh është shpallur fitues në datën 17.05.2024. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky O.E. në datën 20.05.2024 është konstatuar se nuk plotësohej pika 4 dhe 6 e Kriteret e Përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Konkretisht OE M. S. nuk ka dorëzuar *Dokument vërtetues për përvojën e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiare të aktivitetit dhe Mjeti të jetë i pajisur me siguracion të detyrueshëm TPL si dhe siguracion i plot KASKO (mbulim për vjedhje /zjarr/dëme) për të gjithë periudhën e qirasë së plotë Operacionale.* OE nuk ka paraqitur dokument vërtetues për përvoja të suksesshme sipas pikës 4 të kriterëve të përgjithshme gjithashtu automjetet që OE ka vendosur në dispozicion të AK nuk kanë siguracion të plotë KASKO sipas kërkesës të pikës 8. Ky OE është përzgjedhur fitues nga KVO edhe pse oferta e tij nuk rezultoi e vlefshme/suksesshme, veprime këto në mospërputhje me nenin 82 pika 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me shkresën nr.1560 prot., datë 28.05.2024 Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe OE M. C. S. shpk kanë lidhur kontratë me objekt “Shërbimi i marrjes me qira të automjeteve me shofer për strukturën Task-Force”.

Me shkresën nr. 1560 prot., datë 28.05.2024 është nxjerrë urdhër i brendshëm me nr.94 për ndjekjen dhe administrimin e kontratës. H. H. është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen dhe administrimin e kontratës.

Në lidhje me Urdhërshpenzimet për pagesën e qirasë së zyrave të Taskforcës, u konstatua:

Me shkresën nr. 1073/1 prot., datë 04.04.2024 titullari i AK ka nxjerrë urdhërin e brendshëm nr. 51 për “Ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojë ambienti që do të merret me qira për zyra për strukturën e Task-Forcës”. Ky komision përbëhej nga G. L., J. H. dhe M. M..

Në datën 04.04.2024 komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe kërkesave të përgjithshme ka mbajtur procesverbal ku ka përcaktuar fondin limit dhe specifikimet për ambientin që AK është i interesuar për ta marrë me qira. Komisioni ka përcaktuar fondin limit në vlerën 220,500 lekë mbështetur në çmimin e referencës së zonë, si dhe në studimin e tregut në të cilën është referuar dhe sipërfaqe të paktën 250m<sup>2</sup>, të ketë minimum 2 zyra të ndara dhe një hapsirë open space dhe 2 tualete funksionale. Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nuk ka asnjë dokument që tregon çmimin e referencës dhe oferta që janë marrë për studimin e tregut dhe përllogaritjen e fondit limit veprime në mospërputhje me nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për sipërfaqen minimum 250 m<sup>2</sup> nuk ka asnjë argumentim ligjor dhe teknik si ka dalë kjo vlerë. Gjithashtu tek specifikimet e ambientit janë vendosur konkretisht: *vendndodhja e ambienteve të jetë në afërsi (me një reze 1.5 km nga zyrat qendrore të agjencisë) lehtësisht i identifikueshëm dhe objekti të ketë ambient të përshtatshëm për zyra, parkim deri në 5 automjete.* Vendosja e këtyre kërkesave(kritereve) dhe përllogaritja e sipërfaqes nuk është e argumentuar teknikisht/ligjërish veprime në mospërputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 2 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Data e fundit e pranimit të ofertave është vendosur data 15.04.2024. Shpallja është bërë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizime (AKUK).

Me shkresën nr. 1073/2 prot., datë 04.04.2024 titullari i AK ka nxjerrë urdhërin e brendshëm nr. 52 për “Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e dokumentacionit për ambientet që do të merret me qira për zyra për strukturën e Task-Forcës”. Ky komision përbëhej nga J. G., B. H.dhe K. S..

Në datën 08.04.2024 (protokolluar me nr.1132 prot., datë 11.04.2024 pranë AKUK) OE D&L A shpk ka dërguar ofertën për ambient me qira. Oferta për këtë ambient është 220,500 lekë dhe shpenzimet administrative mujore 80,000 lekë pa tvsh të përfshirë. Oferta e OE është një sipërfaqe ndërtese prej 228,44m<sup>2</sup> e cila disponon tre zyra të ndara dhe në planimetri këto ambiente nuk kanë tualete të përfshira edhe pse në ofertë është cilësuar se disponon tualete funksionale të ndara sipas gjinisë (secili nga tre). Parkimi për 5 automjetet e kërkuar është përfshirë në çmimin e shpenzimeve administrative dhe jo në çmimin e qirasë që është kërkuar nga AK duke tejkaluar vlerën e fondit limit. Oferta për këtë ambient është 220,500 lekë dhe shpenzimet administrative mujore 80,000 lekë pa tvsh të përfshirë duke tejkaluar fondin limit prej 220,500 lekë të vendosur nga AK.

Me shkresën nr. 1132/1 prot., datë 15.04.2024 titullari i AK i është drejtuar OE D&L se pas verifikimit të dokumentacionit nga Komisioni i Marrjes me Qira është konkluduar se dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj është në përputhje me kërkesat e publikuara nga AK. Duke njoftuar që brenda datës 22.04.2024 të paraqiten pranë AKUK dokumentacionin e noterizuar për të vijuar me nënshkrimin e kontratës. Komisioni i ngritur me urdhër nr.52 datë 04.04.2024 nuk ka mbajtur proces-verbal për të dokumentuar vlerësimin e ofertës. Gjithashtu ky komision ka kualifikuar si të suksesshme një ofertë e cila është me e lartë se fondi limit. Vlera e fondit limit për këtë shërbim ishte 220,500 lekë ndërkohë që AK ka lidhur një kontratë ku Neni 5 i kontratës tregon se vlera e qirasë është 220,500 leke dhe 80,000 lekë pa tvsh shpenzimet administrative (ku përfshihet edhe parkimi i 5 automjeteve nga ora 09:00-21:00) duke tejkaluar vlerën e fondit limit për këtë shërbim me vlerë 80,000 lekë pa tvsh. Gjithashtu sipërfaqja minimale e kërkuar për ambientet ishte 250 m<sup>2</sup> ndërkohë ambientet që janë marrë me qira janë 228,44m<sup>2</sup> ose 21.56 m<sup>2</sup> më pak. Veprime këto në mospërputhje me nenin 2 dhe nenin 82 pika 2 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me shkresën nr. 1306 prot., datë 30.04.2024 është lidhur kontrata e qirasë me objekt “Marrje me qira ambiente zyresh për strukturën e Task-Forcës” ndërmjet AKUK dhe OE D&L A shpk. Me shkresën nr. 1306/1 prot., datë 02.05.2024 titullari i AK ka nxjerrë urdhër për ndjekjen dhe administrimin e kontratës duke caktuar H. H. si person përgjegjës.

### **Subvencion (Llogaria 603)**

Në bazë të Udhëzimit nr. 2, datë 26.03.2024 “Për miratimin e Metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencionin shtetëror, për ofertuesit e shërbimeve në sektorin e Ujësjellës - Kanalizimeve, për vitin buxhetor 2024”:

Detajimi i fondit të subvencionit dhe përdorimi i tij do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahet nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (në vijim AKUK) në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit, në përputhje me zërin buxhetor subvencione, me llogari ekonomike (603) dhe të gjithë shtesave të tjera të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Subvencioni sipas pikës 1 të kësaj metodologjie do të shpërndahet për të subvencionuar konsumin e parashikuar në pikën 4 të kësaj metodologjie, për kategoritë në nevojë.

3. Kategoritë në nevojë që përfitojnë nga kompensimi për konsumin e sasisë minimale jetike të ujit të pijshëm, janë subjektet e parashikuara në nenin 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

4. Kategoritë e përcaktuara në pikën 3 të kësaj metodologjie, do të kompensohen në masën 100% për vlerën e faturuar deri në sasinë 5 m<sup>3</sup>/muaj (pesë metër kub në muaj) ujë të pijshëm për kontratë, për të përmbushur nivelin minimal jetik. Për këto kategori do të subvencionohet edhe tarifa fikse, tarifa e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban. Zbritja për kategoritë e përcaktuara në pikën 3 të kësaj metodologjie bëhet automatikisht në faturën mujore të gjeneruar nga shoqëria përkatëse ujësjellës kanalizime.

5. Kompensimi jepet vetëm një herë për një familje, pavarësisht nëse ato mund të kenë në përbërje persona që përfshihen në më shumë se një nga grupimet e pikës 3 të kësaj metodologjie, apo kanë në përbërje më shumë se një anëtar që i lind e drejta e përfitimit.
6. Prioriteti për përdorimin e fondit nga shoqëritë aksionere të ujësjellës-kanalizimeve (rajonale ose jo) është si më poshtë: a) Shoqëritë e përdorin fondin për të akorduar çdo muaj, përmes një zbritjeje 100% në shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të kategorive të përcaktuara në pikën 3 të kësaj metodologjie, deri në masën 5 m<sup>3</sup>/muaj; b) Pjesa e mbetur e fondit të subvencionit, nëse do të jetë rasti, do të përdoret nga shoqëritë UK për mbulimin e kostos së energjisë elektrike, me kusht që shoqëritë të kenë mbi 75% të volumit të prodhimit të ujit me ngritje mekanike.
7. Janë të ligjshme për të përfituar nga subvencioni sipas pikës 1 të kësaj metodologjie, vetëm shoqëritë UK që kanë nënshkruar kontratën e performancës me AKUK-në.
8. Shoqëritë që nuk kanë nënshkruar marrëveshjen e performancës me AKUK-në nuk do të rimbursohen për zbritjet e aplikuara sipas pikës 6 të kësaj metodologjie.
9. Zbritja e parashikuar në pikën 6, shkronja “a” të kësaj metodologjie është e detyrueshme edhe për shoqëritë që nuk kanë nënshkruar kontratën e performancës. Kostoja e shoqërive UK që nuk kanë nënshkruar kontratën e performancës do të mbulohet nga fondet e vetë shoqërisë UK, dhe vetëm pas nënshkrimit të kontratës së performancës, këto shoqëri janë të ligjshme të përfitojnë nga subvencioni sipas pikës 1, të kësaj metodologjie.
10. Shoqëritë UK pajisen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit territorial të tyre, në formë shkresore dhe elektronike, si dhe nëpërmjet Regjistratit Elektronik Kombëtar, nëse sistemet mund të komunikojnë automatikisht ndërmjet tyre, me listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë nën juridiksionin e bashkisë, subjekt i trajtimit me ndihmë ekonomike, brenda datës 10 të çdo muaji, sipas formatit në shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, i cili shoqërohet edhe nga vendimi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.
11. Vlerësimi i nevojave për fondin e dhënë sipas pikës 6 të kësaj metodologjie, si dhe detajimi dhe shpërndarja nga AKUK-ja në përputhje me këtë udhëzim, do të bazohet në të dhënat e raportuara nga shoqëritë UK pranë AKUK-së, në përputhje me kërkesat, formatin sipas shtojcës nr. 1 dhe afatet e përcaktuara prej tij.
12. AKUK-ja vlerëson dokumentacionin/et të dhënat e paraqitur/a dhe bën shpërndarjen e subvencionit, për shoqëritë UK brenda muajve qershor dhe dhjetor 2024.
13. AKUK-ja llogarit vlerën e subvencionit sipas pikës 6 të kësaj metodologjie, që do të përfitojë secila shoqëri UK dhe njofton shoqëritë si më poshtë: a) Në lidhje me subvencionin sipas pikës 6, shkronja “a” të kësaj metodologjie, llogaritja e AKUK-së bazohet në informacionin e paraqitur nga shoqëria UK sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi; b) Në lidhje me subvencionin sipas pikës 6, shkronja “b”, të kësaj metodologjie, llogaritja e AKUK-së bazohet në të dhënat e administruara nga shoqëritë UK sipas formateve të raportimit të miratuara nga AKUK-ja.
14. AKUK-ja, në zbatim të vendimit të shkronjës “k”, të nenit 13, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve” të ndryshuar, ka të drejtë të ushtrojë kontrollë nëpërmjet njësisë së posaçme të ngritur për këtë qëllim, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për çdo shoqëri, që ka përfituar nga fondi i subvencionit.

Nga AKUK u vendosën në dispozicion pasqyrat financiare dhe u krahasuan vlerat e raportuara te Banka Botërore.

**Tabela nr 13:** Llogaria 603

në mijë lekë

		Vlera e raportuar në BB	Vlera në pasqyra financiare	Diferenca
603	Subvencionet	350,000	350,000	0

Burimi: AKUK

Nga auditimi rezulton se nuk ka diferencë në vlerën e raportuar për llogarinë 603.

Duke krahasuar vlerat e raportuara nga AKUK te Banka Botërore dhe vlerat e detajimit sipas shpërndarjes, sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela nr 14:** Shpërndarja e subvencionit

në mijë lekë

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024			Vlerat sipas detajimit të llogarisë 603	Diferenca
	Shtresat ne nevojë	Faturat e energjisë	Total		
Shoqëria rajonale UK Durrës sh.a	26	75,000	75,026	75,026	0
Shoqëria rajonale UK Elbasan sh.a	2,268	50,000	52,268	52,268	0
Shoqëria rajonale UK Fier sh.a	1,702	45,000	46,702	46,702	0
Shoqëria rajonale UK Lezhë sh.a	1,412	-	1,412	1,412	0
Shoqëria rajonale UK Lushnje sh.a	496	-	496	496	0
Shoqëria rajonale UK Shkodër sh.a	1,208	60,000	61,208	61,208	0
Shoqëria rajonale UK Vlorë sh.a	114	72,028	72,142	72,142	0
Shoqëria rajonale UK Dibër sh.a	2,494	-	2,494	2,494	0
Shoqëria rajonale UK Pogradec sh.a	8,627	-	8,627	8,627	0
Shoqëria rajonale UK Korçë sh.a	6,300	-	6,300	6,300	0
Shoqëria rajonale UK Kukës sh.a	3,078	-	3,078	3,078	0
Shoqëria rajonale UK Gjirokastrë sh.a	787	-	787	787	0
Shoqëria rajonale UK Berat sh.a	1,009	-	1,009	1,009	0
Shoqëria rajonale UK Sarandë sh.a	796	-	796	796	0
Shoqëria rajonale UK Tiranë sh.a	605	-	605	605	0
Shoqëria UK Vorë	50	17,000	17,050	17,050	0
<b>Total</b>	<b>30,972</b>	<b>319,028</b>	<b>350,000</b>	<b>350,000</b>	<b>0</b>

Burimi: AKUK

Nga grupi i auditimit u kërkua detajimi përkatës për llogarinë 603 si dhe kontabilizimi i kësaj llogarie.

**Tabela nr 15:** Shpërndarja e subvencionit

në lekë

Nr. USH	Data	Emërtim	Përshkrimi	Kredi	Debi
				<b>520</b>	<b>603</b>
227	30.07.24	SHRUK Lushnjë	Shpërndarje subvencionit	133,355.00	133,355.00
228	30.07.24	SHRUK Lezhë	Shpërndarje subvencionit	187,022.00	187,022.00
229	30.07.24	SHRUK Fier	Shpërndarje subvencionit	518,443.00	518,443.00
230	30.07.24	SHRUK Pogradec	Shpërndarje subvencionit	2,461,532.00	2,461,532.00
242	02.08.24	SHRUK Kukës	Shpërndarje subvencionit	452,850.00	452,850.00
247	08.08.24	SHRUK Dibër	Shpërndarje subvencionit	366,248.00	366,248.00
279	10.09.24	SHRUK Korçë	Shpërndarje subvencionit	2,070,844.00	2,070,844.00
432	30.12.24	SHRUK Durrës	Shpërndarje subvencionit	75,000,000.00	75,000,000.00
433	30.12.24	SHRUK Elbasan	Shpërndarje subvencionit	50,000,000.00	50,000,000.00
434	30.12.24	SHRUK Fier	Shpërndarje subvencionit	45,000,000.00	45,000,000.00
435	30.12.24	SHRUK Shkodër	Shpërndarje subvencionit	60,000,000.00	60,000,000.00
436	30.12.24	SHRUK Vlorë	Shpërndarje subvencionit	72,028,019.00	72,028,019.00
437	30.12.24	UK Vorë	Shpërndarje subvencionit	17,000,000.00	17,000,000.00
439	08.01.25	SHRUK Lushnjë	Shpërndarje subvencionit	362,524.00	362,524.00

440	08.01.25	SHRUK Fier	Shpërndarje subvencioni	1,183,224.00	1,183,224.00
441	08.01.25	SHRUK Korçë	Shpërndarje subvencioni	4,229,200.00	4,229,200.00
442	08.01.25	SHRUK Gjirokastrë	Shpërndarje subvencioni	786,988.00	786,988.00
443	08.01.25	SHRUK Kukës	Shpërndarje subvencioni	2,625,205.00	2,625,205.00
444	08.01.25	SHRUK Pogradec	Shpërndarje subvencioni	6,165,166.00	6,165,166.00
445	08.01.25	SHRUK Lezhë	Shpërndarje subvencioni	1,225,454.00	1,225,454.00
446	08.01.25	SHRUK Berat	Shpërndarje subvencioni	1,008,607.00	1,008,607.00
447	08.01.25	SHRUK Durrës	Shpërndarje subvencioni	26,351.00	26,351.00
448	08.01.25	SHRUK Sarandë	Shpërndarje subvencioni	796,044.00	796,044.00
449	08.01.25	UK Vorë	Shpërndarje subvencioni	49,920.00	49,920.00
450	08.01.25	UK Tiranë	Shpërndarje subvencioni	604,568.00	604,568.00
451	08.01.25	SHRUK Vlorë	Shpërndarje subvencioni	114,489.00	114,489.00
452	08.01.25	SHRUK Shkodër	Shpërndarje subvencioni	1,208,055.00	1,208,055.00
453	08.01.25	SHRUK Elbasan	Shpërndarje subvencioni	2,268,456.00	2,268,456.00
454	08.01.25	SHRUK Dibër	Shpërndarje subvencioni	2,127,436.00	2,127,436.00
<b>Totali</b>				<b>350,000,000.00</b>	<b>350,000,000.00</b>

Nga krahasimi i vlerave të raportuara te Banka Botërore rezulton se nuk ka diferenca në raportim dhe vlera e kontabilizuar.

Bashkëlidhur Urdhërshpenzimeve gjendet dokumentacioni justifikues, konkretisht:

Memo mbi përlllogaritjen e vlerës së subvencionit e hartuar nga Drejtoria e Koordinimit Analizës dhe Informacionit, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtor i Përgjithshëm i AKUK.

Praktika e plotë e ardhur nga Ujësjetllës, ku përmbahet i gjithë dokumentacioni sipas formateve të Udhëzimit nr. 2, datë 26.03.2024 “Për miratimin e Metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencionin shtetëror, për ofertuesit e shërbimeve në sektorin e Ujësjetllës - Kanalizimeve, për vitin buxhetor 2024”, konkretisht disa prej tyre:

Urdhërshpenzimi nr. 449, datë 08.01.2025 me vlerë 49,920 lekë, bashkëlidhur Memo nr. 3913, datë 30.12.2024 ku përcaktohet shuma që do të subvencionohet në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga Ujësjetllësi i Vorës. Praktika me gjithë dokumentacionin e dërguar e protokolluar në AKUK me nr. 3742, datë 19.12.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 450, datë 08.01.2025 me vlerë 604,568 lekë, bashkëlidhur Memo nr. 3915, datë 30.12.2024 ku përcaktohet shuma që do të subvencionohet në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga Ujësjetllësi i Tiranës. Praktika me gjithë dokumentacionin e dërguar e protokolluar në AKUK me nr. 3645, datë 10.12.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 451, datë 08.01.2025 me vlerë 114,489 lekë, bashkëlidhur Memo nr. 3917, datë 30.12.2024 ku përcaktohet shuma që do të subvencionohet në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga Ujësjetllësi i Vlorës. Praktika me gjithë dokumentacionin e dërguar e protokolluar në AKUK me nr. 3740, datë 19.12.2024.

Urdhërshpenzimi nr. 452, datë 08.01.2025 me vlerë 1,208,055 lekë, bashkëlidhur Memo nr. 3918, datë 30.12.2024 ku përcaktohet shuma që do të subvencionohet në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga Ujësjetllësi i Shkodrës. Praktika me gjithë dokumentacionin e dërguar e protokolluar në AKUK me nr. 3708, datë 16.12.2024.

Referuar pikës 14 të Udhëzimit nr. 2, datë 26.03.2024 “Për miratimin e Metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencionin shtetëror, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e Ujësjetllës - Kanalizimeve, për vitin buxhetor 2024”, AKUK-së, në zbatim të vendimit të shkronjës “k”, të nenit 13, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve” të ndryshuar, ka të drejtë të ushtrojë kontrolle nëpërmjet njësisë së posaçme të ngritur për këtë qëllim, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për çdo shoqëri, që ka përfituar nga fondi i subvencionit.

Nga auditimi rezulton se AKUK nuk ka kryer asnjë kontroll nëpërmjet njësisë së posaçme të ngritur për këtë qëllim, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për çdo shoqëri, që ka përfituar nga fondi i subvencionit.

### **Llogaria 231**

Për raportimin e kësaj llogarie janë përfshirë 39 projekte, nga të cilat 8 projekte janë zbatuar nga AKUK dhe vetëm për një prej tyre ka pagesa për vitin 2024:

**Tabela nr 16: Projektet e AKUK**

në mijë lekë								
Kodi i projektit	Titulli i projektit	Realizimi 2024	Plani i rishikuar final 2024	Ndryshimi vjetor (Plan-Realizim)	Vlera e Projektit	Vlera e kontratës	Pagesat kumulative më 31 dhjetor 2024	Angazhimet me 31 dhjetor 2024
19AE010	Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos, Loti III	326,619	326,619	-	740,721	740,721	326,619	414,103
19AE323	Furnizimi me ujë të zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik; Draleos, Drimadhes dhe Dhërmi, Faza I	516,922	516,922	-	816,000	816,000	516,922	299,078
19AE325	Ujësjiellësi rajonal i Finiqit, Burimet e Merkos, rrjeti shpërndarës për fshatrat Livadhja dhe Vagalat	59,849	59,921	73	190,684	190,684	190,043	641
19AF925	Rikonstruksioni I skemës së furnizimit me ujë për fshatin Podgorie, Bashkia Maliq	157,964	157,964	-	389,818	364,278	157,964	206,314
19AG315	Ndërtim rrjet ujësjellësi qytetit Mamuras punimesh për objektin: Rikonstruksion i rrjetit të fshatit Dajç, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë	177,778	177,778	-	688,888	619,812	177,778	442,035
19AG411	Furnizimi me ujë I fshatrave Prokuc, Kalluc dhe sistemi I Kuz Fshati Bregas.	40,428	40,428	-	202,142	171,600	40,428	131,172
19AG417	Furnizim me ujë të fshatit Munushitir-Radesh-Orizaj, Bashkia Skrapar	27,424	31,547	4,123	157,733	147,332	27,424	119,908
20AD716	Sigurimit dhe përmirësimin të rrethimit të burimeve dhe depove të ujit për SHR UK Durrës	40,880	40,880	-	304,399	288,889	40,880	248,009

Burimi: AKUK

#### **Projekti 19AE325 Ujësjiellësi rajonal i Finiqit, Burimet e Merkos, rrjeti shpërndarës për fshatrat Livadhja dhe Vagalat:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 84, datë 11.04.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Ujësjiellësi Rajonal i Finiqit, Burimet e Merkos, rrjeti shpërndarës për fshatrat Livadhja dhe Vagalat” me vlerën 21,233,056 lekë (vlera totale e punimeve 22,350,585 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 1,117,529 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 103, datë 17.04.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Ujësjiellësi Rajonal i Finiqit, Burimet e Merkos, rrjeti shpërndarës për fshatrat Livadhja dhe Vagalat” me vlerën 17,928,234 lekë (vlera totale e punimeve 18,871,825 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 943,591 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 486, datë 14.01.2025 nga AKUK është kryer pagesa për “Ujësjiellësi Rajonal i Finiqit, Burimet e Merkos, rrjeti shpërndarës për fshatrat Livadhja dhe Vagalat” me vlerën 17,317,379 lekë (vlera totale e punimeve 18,228,820 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 911,441 lekë).

Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 59,451,230 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 2,972,531 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 56,478,668 lekë.

**Projekti 19AF925 Rikonstruksioni i skemës së furnizimit me ujë për fshatin Podgorie, Bashkia Maliq:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 381, datë 21.11.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Rikonstruksioni i skemës së furnizimit me ujë për fshatin Podgorie, Bashkia Maliq” me vlerën 74,065,471 lekë (vlera totale e punimeve 77,963,654 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 3,898,183 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 466, datë 09.01.2025 nga AKUK është kryer pagesa për “Rikonstruksioni i skemës së furnizimit me ujë për fshatin Podgorie, Bashkia Maliq” me vlerën 76,000,000 lekë (vlera totale e punimeve 80,000,000 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 4,000,000 lekë).

Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 157,963,654 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 7,898,183 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 150,065,471 lekë.

**Projekti 19AG315 Ndërtim rrjet ujësjellësi qytetit Mamuras punime për objektin: Rikonstruksion i rrjetit të fshatit Dajç, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 402, datë 05.12.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Ndërtim rrjet ujësjellësi qytetit Mamuras punime për objektin: Rikonstruksion i rrjetit të fshatit Dajç, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë” me vlerën 70,103,388 lekë (vlera totale e punimeve 73,793,040 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 3,689,652 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 492, datë 15.01.2025 nga AKUK është kryer pagesa për “Ndërtim rrjet ujësjellësi qytetit Mamuras punime për objektin: Rikonstruksion i rrjetit të fshatit Dajç, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë” me vlerën 98,785,322 lekë (vlera totale e punimeve 103,984,550 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 5,199,228 lekë).

Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 177,777,590 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 8,888,880 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 168,888,710 lekë.

**Projekti 19AG411 Furnizimi me ujë i fshatrave Prokuc, Kalluc dhe sistemi i Kuz Fshati Bregas:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 425, datë 23.12.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Furnizimi me ujë i fshatrave Prokuc, Kalluc dhe sistemi i Kuz Fshati Bregas” me vlerën 18,819,393 lekë (vlera totale e punimeve 19,809,887 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 990,494 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 465, datë 09.01.2025 nga AKUK është kryer pagesa për “Furnizimi me ujë i fshatrave Prokuc, Kalluc dhe sistemi i Kuz Fshati Bregas” me vlerën 19,587,532 lekë (vlera totale e punimeve 20,618,455 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 1,030,923 lekë).

Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 40,419,342 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 2,021,417 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 38,397,925 lekë.

**Projekti 19AG417 Furnizim me ujë të fshatit Munushtir-Radesh-Orizaj, Bashkia Skrapar:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 482, datë 13.01.2025 nga AKUK është kryer pagesa për “Furnizim me ujë të fshatit Munushtir-Radesh-Orizaj, Bashkia Skrapar” me vlerën 26,052,458 lekë (vlera totale e punimeve 27,423,640 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 1,371,182 lekë).

Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 27,423,640 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 1,371,182 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 26,052,458 lekë.

**Projekti 20AD716 Sigurimit dhe përmirësimit të rrethimit të burimeve dhe depove të ujit për SHRUK Durrës:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 464, datë 09.01.2025 nga AKUK është kryer pagesa për “Sigurimit dhe përmirësimit të rrethimit të burimeve dhe depove të ujit për SHRUK Durrës” me vlerën 38,835,725 lekë (vlera totale e punimeve 40,879,711 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 2,043,986 lekë).

Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 27,423,640 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 1,371,182 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 26,052,458 lekë.

**Projekti 19AE010 Rikonstrukcion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos, Loti III:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 125, datë 03.05.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Rikonstrukcion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos, Loti III” me vlerën 58,712,479 lekë (vlera totale e punimeve 61,802,610 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 3,090,131 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 208, datë 08.07.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Rikonstrukcion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos, Loti III” me vlerën 67,635,937 lekë (vlera totale e punimeve 71,195,723 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 3,559,786 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 265, datë 06.08.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Rikonstrukcion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos, Loti III” me vlerën 86,878,557 lekë (vlera totale e punimeve 91,451,113 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 4,572,556 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 514, datë 20.01.2025 nga AKUK është kryer pagesa për “Rikonstrukcion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos, Loti III” me vlerën 97,060,756 lekë (vlera totale e punimeve 102,169,217 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 5,108,461 lekë).

Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 326,618,633 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 16,330,934 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 310,287,729 lekë.

**Projekti 19AE323 Furnizimi me ujë të zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik; Dralos, Drimadhes dhe Dhërmi, Faza I:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 194, datë 01.07.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Furnizimi me ujë të zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik; Dralos, Drimadhes dhe Dhërmi, Faza I” me vlerën 112,411,079 lekë (vlera totale e punimeve 118,327,452 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 5,916,373 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 264, datë 26.08.2024 nga AKUK është kryer pagesa për “Furnizimi me ujë të zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik; Dralos, Drimadhes dhe Dhërmi, Faza I” me vlerën 141,774,387 lekë (vlera totale e punimeve 149,236,197 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 7,461,810 lekë).

Me Urdhërshpenzimin nr. 462, datë 04.01.2025 nga AKUK është kryer pagesa për “Furnizimi me ujë të zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik; Dralos, Drimadhes dhe Dhërmi, Faza I” me vlerën 236,890,853 lekë (vlera totale e punimeve 249,358,793 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 12,467,940 lekë).

**Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 516,922,411 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 25,846,122 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 491,076,319 lekë.**

**Nga auditimi rezulton se nuk ka diferenca midis vlerës së raportuar të BB dhe totalit të vlerës në llogarinë 231 për çdo projekt.**

**Projekti 19AG305 Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh në njësinë administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë- Loti i II:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 1747, datë 31.12.2024 nga Bashkia Lezhë është kryer pagesa për “Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh në njësinë administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë- Loti i II” me vlerën 4,066,037 lekë (vlera totale e punimeve 4,280,039 lekë, dhe garancia e punimeve 5% në vlerën 214,002 lekë).

**Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 4,280,039 lekë, nga ku janë mbajtur garanci në vlerën 214,002 lekë dhe pagesa në thesar rezulton në vlerën 4,066,037 lekë.**

**Projekti 19AF838 Rikonstrukcion i plotë i ujësjellësave të fshatrave Kotorr dhe Stror, si dhe ndërtimi i ujësjellësit të ri, fshati Liras, Nj.A. Pishaj:**

Me Urdhërshpenzimin nr. 13, datë 18.12.2024 nga SHRUK Elbasan është kryer pagesa për “Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh në njësinë administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë- Loti i II” me vlerën 24,547,568 lekë.

**Vlera totale e paguar për këtë Projekt është 24,547,568 lekë.**

**Projekti 19AF234 Ndërtim i linjës kryesore të ujësjellësit dhe rrjetit shpërndarës për fshatrat e njësisë administrative Xiber, Bashkia Klos**

Me Urdhërshpenzimin nr. 13, datë 18.12.2024 nga SHRUK Elbasan është kryer pagesa për “Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh në njësinë administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë- Loti i II” me vlerën 24,547,568 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr. 12, datë 13.12.2024 nga SHRUK Elbasan është kryer pagesa për “Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh në njësinë administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë- Loti i II” me vlerën 30,126,000 lekë.

**Projekti 18BQ381 Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për njësinë administrative Golaj, për fshtatrat Dobrone, Qarr i vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has**

Me Urdhërshpenzimin nr. 299, datë 20.06.2024 nga Bashkia Has është kryer pagesa për “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për njësinë administrative Golaj, Për fshtatrat Dobrone Qarr i vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has” me vlerën 1,474,823lekë.

**Projekti 19AF244 Furnizimi me ujë i Fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhur**

Me Urdhërshpenzimin nr.39 datë 30.12.2024, nga Ujësjellës Kanalizime Dibër është kryer pagesa për “Furnizimi me ujë i Fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhur” në vlerën 14,809,246 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.53 datë 31.12.2024, nga Ujësjellës Kanalizime Dibër është kryer pagesa për “Furnizimi me ujë i Fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhur” në vlerën 8,447,474 lekë.

**Projekti 19AF220 Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të fshatrave të Njesisë Administrative Derjan dhe Rukaj, Loti III**

Me Urdhërshpenzimin nr.4 datë 26.04.2024, nga Ujësjellës Kanalizime Dibër është kryer pagesa për “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të fshatrave të Njesisë Administrative Derjan dhe Rukaj, Loti III” në vlerën 2,105,375 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.51 datë 31.12.2024, nga Ujësjellës Kanalizime Dibër është kryer pagesa për “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të fshatrave të Njesisë Administrative Derjan dhe Rukaj, Loti III” në vlerën 50,025,614 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.40 datë 31.12.2024, nga Ujësjellës Kanalizime Dibër është kryer pagesa për “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të fshatrave të Njesisë Administrative Derjan dhe Rukaj, Loti III” në vlerën 37,894,625 lekë.

**Projekti 19AF246 Furnizimi me ujë i Fshatit Vakuf, Njësia Administrative Kastriot**

Me Urdhërshpenzimin nr.35 datë 23.12.2024, nga Ujësjellës Kanalizime Dibër është kryer pagesa për “Furnizimi me ujë i Fshatit Vakuf, Njësia Administrative Kastriot” në vlerën 13,135,200 lekë.

**Projekti 19AG512 Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasiar, Iliras, Qesarat, Anë Vjose, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahas dhe qyteti Memaliaj**

Me Urdhërshpenzimin nr.421 datë 22.10.2024, nga Bashkia Memaliaj është kryer pagesa për “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasiar, Iliras, Qesarat, Anë Vjose, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahas dhe qyteti Memaliaj” në vlerën 247,110 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.422 datë 22.10.2024, nga Bashkia Memaliaj është kryer pagesa për “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasiar, Iliras, Qesarat, Anë Vjose, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahas dhe qyteti Memaliaj” në vlerën 370,665 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.541 datë 27.12.2024, nga Bashkia Memaliaj është kryer pagesa për “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasiar, Iliras, Qesarat, Anë Vjose, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahas dhe qyteti Memaliaj” në vlerën 3,722,036 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.542 datë 27.12.2024, nga Bashkia Memaliaj është kryer pagesa për “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasiar, Iliras, Qesarat, Anë Vjose, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahas dhe qyteti Memaliaj” në vlerën 5,583,055 lekë.

*Nga auditimi rezulton se vlera e raportuar në BB është 90,223,000 lekë ndërsa nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion totali i urdhërshpenzimeve rezulton 9,922,866 lekë.*

**Projekti 19AF836 Ndërtim ujësjellësi i fshatrave Klos, Selvijas, Qyrkan, Lumas dhe Floq,(NJ.A. Klos) dhe rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Selitë (NJ.A. Mollas)**

Me Urdhërshpenzimin nr.12 datë 13.12.2024, nga SHRUK Elbasan është kryer pagesa për “Ndërtim ujësjellësi i fshatrave Klos, Selvijas, Qyrkan, Lumas dhe Floq,(NJ.A. Klos) dhe rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Selitë (NJ.A. Mollas)” në vlerën 30,126,000 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.19 datë 31.12.2024, nga SHRUK Elbasan është kryer pagesa për “Ndërtim ujësjellësi i fshatrave Klos, Selvijas, Qyrkan, Lumas dhe Floq (NJ.A. Klos) dhe rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Selitë (NJ.A. Mollas)” në vlerën 52,684,521lekë.

**Projekti 18BQ449 Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh**

Me Urdhërshpenzimin nr.1488 datë 23.12.2024, nga Bashkia Mallakastër është kryer pagesa për “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh” në vlerën 25,000,000 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.1489 datë 23.12.2024, nga Bashkia Mallakastër është kryer pagesa për “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh” në vlerën 75,000,000 lekë.

**Projekti 18CG001 Linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjeti shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit, Faza II**

Me Urdhërshpenzimin nr.123 datë 03.04.2024, nga Bashkia Belsh është kryer pagesa për “Linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjeti shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit, Faza II” në vlerën 7,767,790 lekë nga e cila është mbajtur edhe garancia.

Me Urdhërshpenzimin nr.510 datë 10.12.2024, nga Bashkia Belsh është kryer pagesa për “Linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjeti shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit, Faza II” në vlerën 52,047,706 lekë nga e cila është mbajtur edhe garancia.

*Nga auditimi rezulton se vlera e raportuar në BB është 60,250,000 lekë ndërsa nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion totali i urdhërshpenzimeve rezulton 59,815,496 lekë.*

**Projekti 19AG309 Furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat Brazhdan dhe Ushtelence, Nj.A Qendër**

Me Urdhërshpenzimin nr.27 datë 03.10.2024, nga SHRUK Dibër është kryer pagesa për “Furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat Brazhdan dhe Ushtelence, Nj.A Qendër” në vlerën 18,473,393 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.3 datë 14.05.2024, nga SHRUK Dibër është kryer pagesa për “Furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat Brazhdan dhe Ushtelence, Nj.A Qendër” në vlerën 4,327,247 lekë.

*Nga auditimi rezulton se vlera e raportuar në BB është 22,931,000 lekë ndërsa nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion totali i urdhërshpenzimeve rezulton 22,800,640 lekë.*

**Projekti 20AD705 Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Shënavlash, Njësia adm. Rrashbull, Bashkia Durrës**

Me Urdhërshpenzimin nr.13 datë 04.09.2024, nga Bashkia Durrës është kryer pagesa për “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit në fshatit Shënavlash, nj.adm Rrashbull, Bashkia Durrës” në vlerën 6,799,584 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.14 datë 04.09.2024, nga Bashkia Durrës është kryer pagesa për “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit në fshatit Shënavlash, nj.adm Rrashbull, Bashkia Durrës” në vlerën 5,695,920 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.15 datë 04.09.2024, nga Bashkia Durrës është kryer pagesa për “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit në fshatit Shënavlash, nj.adm Rrashbull, Bashkia Durrës” në vlerën 5,363,520 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr.4 datë 08.04.2024, nga Bashkia Durrës është kryer pagesa për “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit në fshatit Shënavlash, nj.adm Rrashbull, Bashkia Durrës” në vlerën 26,092,221 lekë.

*Nga auditimi rezulton se vlera e raportuar në BB është 70,000,000 lekë ndërsa nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion totali i urdhërshpenzimeve rezulton 43,951,245 lekë.*

**Projekti 19AF915 Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec**

Me Urdhërshpenzimin nr. 257 datë 21.11.2024, nga Bashkia Pustec është kryer pagesa për “Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec” në vlerën 9,395,702 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr. 256 datë 11.10.2024, nga Bashkia Pustec është kryer pagesa për “Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec” në vlerën 38,204,633 lekë.

Me Urdhërshpenzimin nr. 63 datë 08.04.2024, nga Bashkia Pustec është kryer pagesa për “Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec” në vlerën 3,113,898 lekë.

*Nga auditimi rezulton se vlera e raportuar në BB është 97,600,000 lekë ndërsa nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion totali i urdhërshpenzimeve rezulton 50,714,233 lekë.*

Grupi i auditim hasi vështirësi në vënien në dispozicion të dokumentacionit nga ana e AKUK për projektet e raportuara që janë zhvilluar në Bashkitë dhe Ujësjetllësat e rënë dakord nga BB në lidhje me Urdhërshpenzimet dhe dokumentacionin justifikues.

**Tabela nr 17:** Diferencat

Projekti	Vlera e raportuar	Totali i urdhershpenzimit	në lekë
			Diferenca në raportim
Projekti 19AG512	90,223,000.00	9,922,866.00	80,300,134.00
Projekti 18CG001	60,250,000.00	59,815,496.00	434,504.00
Projekti 19AG309	22,931,000.00	22,800,640.00	130,360.00
Projekti 20AD705	70,000,000.00	43,951,245.00	26,048,755.00
Projekti 19AF915	97,600,000.00	50,714,233.00	46,885,767.00
<b>Totali</b>	<b>341,004,000.00</b>	<b>187,204,480.00</b>	<b>153,799,520.00</b>

Burimi: AKUK

Nga auditimi rezulton se vlerat e raportuara për llogarinë 231 te BB janë bashkë me vlerën e mbajtur të garancisë së punimeve, vlerë e cila mbahet në një llogari në Thesar dhe nuk është një pagesë faktike e kryer.

## IV. REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Pasqyrat financiare të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve përgatiten dhe mbahen në mënyrë manuale në programin Excel dhe nuk janë të integruara me sistemin e Thesarit apo me programe të dedikuara financiare. Kjo praktikë rrit ndjeshëm riskun për ndërhyrje apo ndryshime të paautorizuara në të dhënat financiare të raportuara, pa lënë gjurmë auditimi. Nga verifikimet e kryera rezultoi se vlerat e raportuara pranë Bankës Botërore bazohen në të dhënat e sistemit të Thesarit, mbi bazë cash, dhe nuk përputhen me pasqyrat financiare të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (akruale).

*(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqet 12-32, të Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve të marrë masa për integrimin e një sistemi (software) financiar për hartimin e pasqyrave financiare të projektit, ku të jenë të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që ka akses në sistem, duke ruajtur besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në to.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga llogaria 602 janë paguar rezervimet e hoteleve për udhëtime jashtë vendit sipas faturave të paraqitura nga agjencitë turistike të kontaktuara nga punonjës të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe jo sipas faturave të hoteleve ku punonjësit kanë fjetur gjatë periudhës së shërbimit. Pagesat e kryera ndaj agjencive të udhëtimit/turistike janë në kundërshtim me pikën 9 të Vendimit të KM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” pasi rimbursimi i shpenzimeve të fjetjes në shërbimet jashtë vendit kryhet mbi bazën e faturave të marra në hotel. Si dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve nuk ka nxjerr rregulla të brendshme për organizimin e punës për sigurimin e hoteleve me koston më të ulët.

*(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqet 12-32, të Raportit të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve të marrë masa për hartimin e një praktike rregullatore në lidhje me rezervimin e hoteleve në kuadër të udhëtimit jashtë vendit, me qëllim analizimin e të gjitha opsioneve për sigurimin e tyre me çmim më të ulët.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve nuk ka kryer asnjë kontroll nëpërmjet njësisë së posaçme të ngritur për këtë qëllim, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve, që ka përfituar nga fondi i subvencionit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 26.03.2024 “Për miratimin e Metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencionin shtetëror, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e Ujësjetllës - Kanalizimeve, për vitin buxhetor 2024”, pika 14 shkronja “k”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve” të ndryshuar neni 13.

*(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqet 12-32, të Raportit të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve të marrë masa për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mos kryerjen e kontrolleve dhe të marrë masa në hartimin e një plani dhe kryerjen e kontrolleve mbi përdorimin e fondeve të akorduara për çdo shoqëri përfituese nga fondi i subvencionit.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve të kryera në llogarinë 602 rezultojnë se:

- Me Urdhër-shpenzimi nr. 296, datë 19.09.2024, me vlerën 1,019,646 lekë është paguar “Shërbimi i marrjes me qira të automjetit me shofer për strukturën e Task Forcës”. Nga auditimi i dosjes për këtë praktikë/procedurë prokurimi u konstatua se, Operatori Ekonomik fitues “M. S.” nuk plotësonte kriterin nr. 4 dhe 6 të Kritereve të Përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Operatori Ekonomik është përzgjedhur fitues nga KVO edhe pse oferta e tij nuk rezultoi e vlefshme/suksesshme, veprime këto në mospërputhje me nenin 82 pika 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Në lidhje me Urdhër-shpenzimet për pagesën e qirasë së zyrave të Taskforcës, nga auditimi i dosjes për këtë praktikë/procedurë u konstatua: Vendosija e kërkesave (kritereve) dhe përlllogaritja e sipërfaqes nuk është e argumentuar teknikisht/ligjërishit veprime në mospërputhje me nenin 36 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Dosjet fizike të prokurimit nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes, duke mos respektuar gjurmën e auditimit për procesin e prokurimit, në mospërputhje me nenet 21, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

*(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqet 12-32, të Raportit të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve të marrë masa për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e prokurimit, me qëllim garantimin e dokumentimit të plotë dhe të argumentuar teknikisht e ligjërishit të kritereve të përcaktuara në procedurat e blerjeve me vlera të vogla, shqyrtimin me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm të ofertave të paraqitura, si dhe realizimin e inventarizimit të plotë të dosjeve të prokurimit.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjatë procesit të auditimit të raportimit për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetllës-Kanalizimeve në Shqipëri, grupi i auditimit u përball me vështirësi në sigurimin dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, lidhur me projektet e zbatuara në bashkitë dhe shoqëritë ujësjetllës-kanalizime të miratuara nga Banka Botërore, konkretisht për urdhër-shpenzimet dhe dokumentacionin justifikues përkatës. Kjo si rrjedhojë e mungesës së një sistemi të konsoliduar për administrimin dhe koordinimin e dokumentacionit financiar ndërmjet Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe njësive zbatuese në nivel vendor, si dhe me dobësitë në mekanizmat e kontrollit të brendshëm për mbledhjen, ruajtjen dhe vënien në dispozicion në kohë të dokumentacionit justifikues.

*(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqet 12-32, të Raportit të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve të marrë masa që, përpara hartimit dhe dorëzimit të raporteve financiare të programit pranë Bankës Botërore, të sigurojë disponimin e kopjeve shkresore ose elektronike të dokumentacionit justifikues për të gjitha llogaritë e raportuara, përfshirë të dhënat e marra nga bashkitë dhe shoqëritë ujësjetllës-kanalizime të miratuara nga Banka Botërore.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 231 (e cila përmban investime kapitale të projekteve të përzgjedhura nga Banka Botërore) rezultoi se për projektet që zhvillohen nga bashkitë dhe ujësjetllësit nuk rakordon vlera e urdhër-shpenzimeve të tyre me vlerën e raportuar nga BB. Konkretisht për 5 projekte vlera e raportuar te Banka Botërore është 341,004,000 lekë krahasuar me totalin e urdhër-shpenzimeve të bashkive dhe ujësjetllësve në vlerën 187,204,480 lekë. Pra rezultoi diferenca prej 153,799,520 lekësh për të cilën nuk u vendos në dispozicion

dokumentacion justifikues, por vlera 341,004,000 lekë rakordon me shpenzimet e kryera nga sistemi i thesart të cilat janë baza mbi të cilat kryehet raportimi në kundërshtim me pikën 56 të PAD (Dokumenti i Vlerësimit të Programit).

*(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqet 12-32, të Raportit të Auditimit)*

**6.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të rakordojë urdhërshpenzimet e bashkive dhe ujësjetësave me vlerat e raportuara te Banka Botërore, dokumentacionin justifikues, si dhe të analizojë situatën e krijuar nga këto mungesa.

**Menjëherë**

*Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**